





Strategji për Maqedoninë e Veriut

2019-2024

Miratuar nga Këshilli i drejtorëve më 22 maj 2019

Përmbajtja dhe fjalorthi i termave



European Bank
for Reconstruction and Development

Përmbajtja		Fjalorthi i termave kryesorë		LK	Largësia nga kufiri
Rezyme e shkurtër	3	APT	Arsim Profesional dhe Trajnim	MEPSO	Operator i Sistemit Elektropërçues të Maqedonisë së Veriut
Maqedonia e Veriut– Shqyrtim i shkurtër i aktiviteteve të BERZH-it	4	BE	Bashkimi Evropian	MFEE	Marrëveshje për furnizimin e energjisë elektrike
I. Zbatimi i angazhimit paraprak (2013 - 2018)	5	BEI	Banka Evropiane për Investim	MMVM	Ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme
Rezultate kyçe transitore të arritura gjatë angazhimit paraprak		BN	Bashkime dhe ndërmarrje	NP	Ndërmarrje Publike
Sfida për implementimin dhe leksione kyçe	5	BP	Ballkani Perëndimor	NPRRSH	Ndërmarrje publike për rrugë shtetërore
II.Kontesti ekonomik	7	BT	Bashkëpunim Teknik	NT	Ndihmë teknike
Konteksti makroekonomik dhe parashikime për periudhën të cilën e përfshin strategjia		CEFTA	Marrëveshja qendrore evropiane për tregti të lirë	NJIP	Njësi për implementimin e projektit
Sfida transitore kyçe	8	EE	Efikasitet energjetik	NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
III. Prioritete të qeverisë dhe angazhimi i palëve të interesuara	8	EJL	Evropa Juglindore	NZHZ	Ndihmë Zhvillimore Zyrtare
IV. Definimi i prioriteteve strategjike të BERZH për Maqedoninë e Veriut	9	ENEF	Fondi për ekspansionin e ndërmarrjeve	OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
V.Korniza e aktiviteteve dhe rezultateve	11	EPT	Efekti i prituri i tranzicionit	OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
VI.Hartimi i komplementaritetit të partnerëve ndërkombëtarë në sferat e punës së BERZH	12	ES	Ekologjik dhe social	OIDDNJ	Organizata për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut
VII. Rreziqe për implementim dhe implikimet ekologjike dhe sociale	13	ESCO	Kompania për shërbime energjetike	OPF	Ofertë publike fillestare
VIII. Vlerësimi i bashkëfinancimit donatorial	16	ETP	Efekti i tranzicionit të portfolios	PFEQJ	Program për financimin e ekonomisë së gjelbër
Aneksi 1 – Vlerësimi politik	17	FEB	Forumi Ekonomik Botëror	PFEQ	Program për financimin e energjisë së qëndrueshme
	18	GEFF	Programi për financimin e ekonomisë së gjelbër	PFT	Program për financim tregtar
	20	GNB	Qeveria ndaj biznesit	PGB	Programi për gra
		GQ	Gazra të qelqtë	PNRR	Program për ndarjen e rreziqeve
		HC	Hidrocentralet	PPP	Partneritet publiko-privat
		HKBP	Hulumtimi i klimës së biznesit dhe punës së ndërmarrjeve	PPPI	Programi për përgatitjen e projekteve infrastrukturore
		HJF	Hua jofunkionale	PREE	Program rajonal për efikasitet energjetik
		IHD	Investime të huaja të drejtpërdrejta	PSH	Prodhim dhe shërbime
		INF	Institucion ndërkombëtar Financiar	PVKER	Plan veprues kombëtar për energji ripërtëritëse
		IPA	Instrument për ndihmë parainkuadruese	SHS	Shëndet dhe Siguri
		IPF	Institucion privat financiar	TEGJ	Tranzicioni ndaj ekonomisë së gjelbër
		ITA	Industri, tregti dhe agrobiznes	TEN-T	BE program për mbështetjen e infrastrukturës transportuese
		IVB	Investime vjetore në biznes	TIK	Teknologji Informatike dhe Komunikuese
		JNPIH	Ndërmarrje publike për infrastrukturë hekurudhore	VP	Vende të punës
		KBV	Këshilla për biznese të vogla	ZGV	Zinxhirë global të vlerave
		KIBP	Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor	WBIF	Kornizë investuese për Ballkanin Perëndimor
		KOP1	Konferenca e ndryshimeve klimaterike e Kombeve të Bashkuara 2015		
		KK	Kontribut Kombëtar		
		KRR	Kapital i rrezikshëm		
		KP	Kapital Privat		
		KNP	Korporata ndërkombëtare financiare		
		KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau		

Përkushtimi i Maqedonisë së Veriut ndaj parimeve politike dhe zbatimit të tyre të paraqitura në Nenin 1 të Marrëveshjes për formimin e Bankës u rrezikuan në mënyrë serioze në pjesën më të madhe të periudhës së miratimit të strategjisë paraprahe për vendin, pasi vendi u ballafaqua me përqendrimin e gjendjes së demokracisë që në raportet relevante të BE-së u kualifikua si “shtet i robëruar” nga udhëheqësia e partisë politike së atëhershme në pushtet. Kriza politike më serioze në Maqedoninë e Veriut nga konflikti i armatosur në vitin 2001 në mënyrë negative ka ndikuar ndaj ekonomisë dhe e pengonte punën e BERZH në vend. Zgjidhja e saj, që kulminoi me ndryshimin e qeverisë në pranverën e vitit 2017 me koalicion të ri pro-reformues të kryesuar nga partia politike kryesore e atëhershme në opozitë shënoi një kthesë të rëndësishme me ç’rast përmirësimet në sferën e qeverisjes të së drejtës, kthimi i kontrollit dhe baraspeshës në sistemin politik dhe agjenda për reformë ekonomike gjithëpërfshirëse u përcaktuan si komponentë kryesorë në programin e saj. Dukjet për përsheptimin e integritimit në institucionet Euroatlantike, veçanërisht afrimi drejt BE-së, pas vendimit të Këshillit Evropian ta trasojë rrugën drejt hapjes së negociatave për inkuadrim në BE në qershor 2019, vazhdojnë të jenë shtylla kryesore për reforma strukturore dhe faktor stabilizimi. Hapi drejt normalizimit të marrëdhënieve me Greqinë fqinje dhe përmirësimi i marrëdhënieve me fqinjët e tjerë në rajon kontribuojnë për rritjen e besimit të investitorëve.

Duke qëndruar në këtë udhëkryq historik, shumë gjëra do të varen prej shtrirjes aktuale dhe tempos së angazhimeve reformuese për orientimin e vendit në rrugën drejt rritjes së qëndrueshme dhe inkluzive. Edhe pse ekonomia shënon përfitime prej pronësisë relativisht të ulët shtetërore, ekonomisë së llojllojshme dhe kornizës së vulltshme rregullatore për udhëheqjen e biznesit, zbatimi i ligjeve në mënyrë të përgjithshme është në nivel të ulët dhe korrupsioni dhe ekonomia gri mbeten pengesat kryesore për zhvillimin e gjithë potencialit ekonomik të vendit. Reformat e paprolongueshme duhet të krijojnë mjedis në të cilin sektori privat mund të zhvillohet jashtë tregut të vogël vendor dhe të krijojë mundësi për punësimin e të rinjve në vend. Hendeqet e tranzicionit janë veçanërisht akute në pjesën e **konkurrencës** (me ekonomi e cila karakterizohet me zbatimin e pabarabartë të rregullave, ekonominë e madhe gri dhe menaxhimin e dobët korporativ), në **integritim** (me zbatimin e ngadalshëm të projekteve transportuese dhe energjetike infrastrukturore, si edhe nivelet e ulëta të aranzhimeve institucionale për tregti dhe investimeve në nivel rajonal) dhe në pjesën e **ekologjisë** (me intensitet të lartë energjetik, ndjeshmëri të rritur të ndryshimeve klimaterike dhe joefikasitet prej resurseve të tjera).

BERZH është pozicionuar mirë për të ndihmuar në përf forcimin e rezultateve të punës në sektorin privat në vend, të sigurojë mbështetje për infrastrukturën e fuqishme dhe të butë dhe për përsheptimin e angazhimeve reformuese për punësim cilësor dhe rritje më ekologjike përmes politikës së zbatueshme dhe instrumenteve financiare. Banka do të vazhdojë të fokusohet në anën e saj tradicionale të fortë për të ndihmuar në plotësimin e agjendës infrastrukturore të vendit dhe ngritjen e standardeve në sektorin privat, më pas në mënyrë të barabartë duke hulumtuar perspektiva të reja për zhvillimin e tranzicionit të vendit drejt ekonomisë së lëvizur prej njohurisë, siç është promovimi i punësimit të grave dhe burrave të rinj, stimulimi i financimit të inovacioneve në kontekst të zhvillimit të tregut të kapitalit, si dhe mbështetja e digjitalizimit dhe promovimi i aftësive TIK. Gjatë gjithë periudhës, integritimi rajonal do të jetë drejtim përmes së cilit do të udhëhiqen investimet e Bankës dhe aktivitetet lidhur me politikën, ndërsa theks i veçantë do të vihet analizimit të sinergjive me aktivitetet e Bankës në ekonominë fqinje. Partneriteti i vazhdueshëm strategjik me BE-në dhe mbështetja e donatorëve në formë të ndihmës teknike dhe granteve investuese të cilat mund të bashkohen me portfolion e produkteve të BERZH do të jenë faktor kyç që Banka t’i plotësojë prioritetet strategjike të radhës në Maqedoninë e Veriut në vitin 2019-2024:

- Mbështetjen e **konkurrencës** përmes përmirësimit të zinxhirëve të vlerave, zhvillimit të aftësive të fuqisë punëtore dhe përf forcimit të menaxhimit;
- Përf forcimin e **integritimit** rajonal, lidhjen e butë dhe mbështetjen e afrimit të BE-së;
- Mbështetjen e tranzicionit ndaj ekonomisë së **gjelbër** përmes miksit energjetik më të qëndrueshëm dhe efikasitetit më të madh të resurseve.

Maqedonia e Veriut – Shqyrtim i shkurtër i aktiviteteve të BERZH




European Bank
for Reconstruction and Development


Aktivitetet investuese të BERZH në Maqedoninë e Veriut (fondi i dhjetorit 2018)

Portfolio	781mil. €	Projekte aktive	46
Kapitali pronësor	1.4%	Mjete qarkulluese	277 mil. €
Pjesëmarrja në sektorin privat ¹	32%	Neto kum. investime	1845 mil. €


IVB dhe aktivitete




Struktura e portfolios



Dinamika e portfolios



Hendeqe të tranzicionit²



Numra në kontekst të Maqedonisë së Veriut

Popullsia (në milionë) ³	2,1	2017
BPV për kokë banori (PFB, dollarë amerikanë) ³	15,290	2017
Indeksi global i konkurrencës (SEF)	68-ta (prej 137)	2017
Papunësia (% , vlerësimi ONP) ⁴ <i>Krahasime: Shqipëria(13,8), BeH (25,6), Mali i Zi (16,0), Serbia (14,1)</i>	22,4	2017
Papunësia tek të rinjtë (% , vlerësimi ONP) ⁴ <i>Krahasime: Shqipëria(30,0), BeH(55,4), Mali i Zi (33,1), Serbia (32,8)</i>	46,9	2017
Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore(% , vlerësimi ONP) ⁴ <i>Krahasime: Shqipëria (47,2), BeH (35,3), Mali i Zi (42,2), Serbia (45,9)</i>	42,5	2017
Intensiteti energjetik (TPES/BPV) ⁵ <i>Krahasime: Shqipëria (0,2), BeH (0,4), Mali i Zi (0,2), Serbia (0,4)</i>	0,3	2015
Intensiteti i emetimit/BPV (kgCO ₂ /10'\$) ⁵ <i>Krahasime: Shqipëria (0,3), BeH (1,2), Mali i Zi (0,5), Serbia (1,1)</i>	0,7	2015

¹ Investime kumulative të Bankës: me periudhë 5-vjeçare të kthimit të portfolios.

² Krahasime: Raporti tranzitor i BERZH 2018-2019. ³ WDI e Bankës Botërore. ⁴ Organizata Ndërkombëtare e Punës. ⁵ Atlasi energjetik IIEA's.


1. Implementimi i angazhimit paraparak (2013-2018)



European Bank
for Reconstruction and Development

1.1. Rezultate kryesore të tranzicionit të arritura gjatë angazhimit paraparak

2




Rezultatet kryesore të tranzicionit		
Tregues kornizë për rezultatet	2017	Nga 2013
Nr. i klientëve për SMB të cilët kanë paraqitur produktivitet të rritur	33	136
Rritja e vëllimit të portfolios për hua për NMVP të bankave partnere t'i shfrytëzojnë mjetet e Bankës	+48%	-20%

- Kontribuoi për integrim më të madh në zinxhirët global të vlerave përmes mbështetjes së IHD:** i investoi 85 milionë euro në kompani në sektorin automobilistik (Draexlmaier Group), sektorin e agrobiznesit (Sutas Group), sektorin e xehetarisë (Euromax Resources), dhe sektorin e patundshmërisë dhe turizmit (Skopje City Mall).
- Edhe përmes likuiditetit të madh në tregun e punës arriti t'i përshtat produktet për NVM për ta lehtësuar qasjen në mjetet financiare:** janë paguar linja kreditore në shumë prej 60 milionë euro, përmes financimit të kombinuar (hua, grante, ndihmë teknike për përgatitjen e projekteve fitimprurëse) dhe mbikëqyrjen e implementimit të projekteve. Siguroi linja kreditore për lehtësimin e tregtisë në shumë prej 75 milionë euro përmes 3 bankave të mëdha komerciale. Drejtpërdrejt financoi katër MSP (13 milionë euro), por kërkesa për kërkesën për hua nga BERZH, duke i përfshirë për linja kreditore nga WIB, mbetet e thjeshtë për shkak të likuiditetit të madh.
- I përmirësoi kapacitetet e NVM** përmes gjithsej 392 projekteve përkatëse, prej të cilave 124 ishin me gra sipërmarrëse; në kuadër të programit Blue Ribbon siguroi mbështetje këshillëdhënëse të Makprogres, prodhues i produkteve konditore, dhe i Aktivit, furnizues ndërkombëtar i metalit për industrinë automobilistike.
- Vendosi instrumente të reja financiare në tregun lokal të kapitalit:** (i) në vitin 2014 themeloi Fond për ekspansionin e ndërmarrjeve (ENEF) në vlerë prej 110 milionë euro të dedikuara për NVM në Ballkanin Perëndimor, (ii) siguroi ND për rishikimin e legjislaturës për faktoring në pajtim me normat dhe procedurat e BE-së, (iii) siguroi financim dhe NT për bursën e Maqedonisë në kuadër të EJT-së linkun për bashkimin e disa bursave në rajon.
- Banka nuk e arriti potencialin e vet të plotë në angazhimin me **komunat**, kryesisht si rezultat i kufizimit të tyre të detyrimit dhe inkuadrimin në mjetet më të lira financiare shtetërore prej INF të tjera.

1.1 Rezultate kryesore të tranzicionit të arritura gjatë angazhimit paraparak

energjetik dhe energjisë së qëndrueshme

Tranzicioni drejt ekonomisë së gjelbër



Rezultate kryesore të tranzicionit

E përmirësot efikasitetin energjetik dhe teknologjitë e gjelbra në të gjitha sektorët përmes linjave kreditore: (i) program me qëllim dhe shumë i suksesshëm për MSP në kuadër të Programit rajonal për efikasitet energjetik për Ballkanin Perëndimor наменска и многу успешна програма за МСП во рамките на Регионалната програма за енергетска ефикасност за Западен Балкан (PREEBP) në vlerë prej 9 milionë euro i nënshkruar me 3 banka komerciale (ii) 2 GEFF linja kreditore (4 milionë euro) që dedikohen për sektorin e popullsisë .

E përmirësoi efikasitetin e rrjetit energjetik përmes sigurimit të huas në vlerë prej 25 milionë euro për kompaninë kombëtare për përcimin e energjisë elektrike (MEPSO) për rehabilitimin e trafostacioneve ekzistuese. Kjo ishte huaja e parë pa garanci shtetërore e cila i është ndarë një kompanie energjetike publike në Ballkanin Perëndimor.

Promovoi kompani ESCO , edhe pse me sukses mesatar: është krijuar formular i standardizuar për ESCO marrëveshje për VP në Ballkanin Perëndimor që të mund të shfrytëzohet nga sektori privat dhe komunat. Një numër i vogël i kompanive ESCO e minojnë progresin e mëtejshëm

E mbështeti legjislaturën për efikasitet energjetik, duke e përfshirë edhe përgatitjen e ligjit për efikasitet energjetik në pajtim me direktivat e BE-së
Në mënyrë të konsiderueshme kontribuoi drejt zhvillimit të energjisë së ripërtëritshme:

✓ Siguroi hua në shumë prej 4.1 milionë euro të Aktual Energy Group për fillimin me punë të hidroelektranës së vogël me kapacitet prej 3MWh. Përgatiti legjislativë sekondare dhe e mbështeti zbatimin e tenderit për energji solare dhe me erë.

- ✓ Përgatiti Studim të fizibilitetit për tenderë për hidroelektrana të reja të vogla (HEV) dhe përgatiti tenderë të rinj për PPP.

- ✓ Përgatiti legjislaturë sekondare dhe e mbështeti implementimin e tenderit për energji solare dhe me erë.

✓ E rishikoi dhe e azhurnoi Studimin e vazhdueshëm fizibiliteti për tenderë për hidroelektrana të reja të vogla (HEV) dhe përgatiti tenderë të rinj për PPP.

✓ E mbështetën vendosjen e programeve për energji të ripërtëritshme në sektorin privat përmes (i) sigurimit të mbështetjes teknike të operatorit të Maqedonisë së Veriut në treg (MEPSO) për rishikimin e Marrëveshjes për furnizimin e energjisë elektrike (MFEE) dhe (ii) sigurimin e ndihmës për autoritetet lokale për finalizimin e MFEE tregtar standard për projekte për energji të ripërtëritshme

Prioriteti 3: Zhvillimi i integritetit rajonal

Korridoret transportuese në EJT



Rezultatet kryesore të tranzicionit

- Banka ka rol kryesor si INF në pikëpamje të investimeve të saj në projekte kryesore transportuese dhe energjetike:

- ✓ Siguroi hua me garanci shtetërore në vlerë prej 270 milionë euro për Ndërmarrjen Publike për Rugë Shtetërore (NPRRS) për ndërtimin e aksit rrugor Kriva Pallankë deri tek kufiri me Bullgarinë si pjesë e Korridorit VIII dhe për drejtimin dhe ruajtjen e rrjetit kombëtar dhe rajonal i cili i lidh qendrat rajonale ekonomike dhe kalimet ndërkombëtare kufitare strategjike në Shqipëri, Bullgari, Greqi, Kosovë dhe Serbi. Siguroi mjete për financimin e Sistemit digital për arkivim për mbështetjen e furnizimeve elektronike për NPRRS.
- ✓ Siguroi hua me garanci shtetërore në vlerë prej 145 milionë euro (një e katërta prej shpenzimeve të përgjithshme të projektit) për Ndërmarrjen Publike për Infrastrukturë Hekurudhore të Maqedonisë së Veriut (NPIH) për modernizim dhe zhvillimin e fazës së 2-të të pjesës lindore të Korridorit hekurudhor Trans-evropian VIII. Mobilizoi grant invstues në shumë prej 69 mil. euro për fazën 1 përmes PFEGJ
- ✓ Nënshkroi hua në vlerë prej 11,5 milionë euro me ofruesin shtetëror kombëtar të shërbimeve për navigacion ajror M-NAV për (i) ta harmonizuar pajisjes e saj me kërkesat rregullatore të zbatueshme në BE (ii) për ta mbështetur procesin e harmonizimit në kuadër të Zonës së përbashkët evropiane të aviacionit.
- ✓ Siguroi hua në vlerë prej 37 milionë euro për MEPSO-n për financimin e transportit të parë interkonektiv midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Banka mobilizoi grant investues prej 12 milionë euro në kuadër të KIBP për investime në rriete të muncura.

Të gjitha projektet janë shoqëruar me grante në vlerë prej 100 milionë euro dhe NT për përgatitjen dhe implementimin e projekteve, të mobilizuara prej Bankës përmes Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Megjithatë, pagesa e huas dhe implementimi i projekteve të mëdha infrastrukturore ishin të ngadalshme si rezultat i kapacitetit të ulët për implementimin e partnerëve kryesorë, mungesën e koordinimit midis ministrave të ndryshme dhe krizës politike dyvjeçare.

- **I lehtësoi marrëveshjet ndërkufitare me Serbinë dhe Kosovën** për thjeshtimin e procedurave ndërkufitare në kuadër të projektit për Korridorin hekurudhor VIII.

- E siguroj ndërtimin e kapaciteteve për siguri në rrugë, duke përfshirë edhe revizionin e sigurisë në rrugë.

1. Implementimi i angazhimit paraprak (2013-2017)



European Bank
for Reconstruction and Development

1.2. Sfidat për implementimin dhe leksione kryesore

Konteksti për implementim:

Nga viti 2013, Banka ka realizuar rezultate në të gjitha aspektet kryesore të strategjisë së saj, kryesisht si INF kryesore në sektorin transportues dhe energjetik dhe kontribues kryesor drejt zhvillimit të sektorit privat, veçanërisht të NVM. Megjithatë, banka nuk mbeti immune në krizën politike afatgjatë në vend (2015-2017), e cila në masë të madhe ndikoi në periudhën e cila e përfshin strategjinë për vendin dhe rezultoi me ulje të menjëhershme të investimeve dhe angazhimet reformuese ekonomike. Kjo de fakto i kufizoi mundësitë e Bankës të implementojë projekte kryesore shtetërore dhe të mbështesë investime të huaja të drejtpërdrejta. Banka reagoi me rritjen e kreditimit në sektorin privat vendor dhe në aktivitetet për PFT (në pjesë të madhe përmes IPF). Para ca kohësh, Banka u diferencua si partner kryesor për tranzicionin ndaj ekonomisë së gjelbër që është dakorduar me pranimin e fuqishëm të linjave të saj kreditore për efikasitetin energjetik dhe këshillat vijuese për politika. Më vonë, ardhja e koalicionit të ri qeveritar preroformues në vitin 2017 e vendosi vendin në rrugë më të qëndrueshme dhe më inkluzive për rritje dhe e përshpejtoi konvergencën me standardet e BE-së, me ç'rast dukjet për përshpejtimin e procesit të inkuadrimin drejt BE-së do të vazhdojnë të jenë bazë kyçe për reforma strukturore. Banka mund të luaj rol të rëndësishëm me sigurimin e mbështetjes në procesin e inkuadrimin drejt BE-së dhe përmes zhvillimit të projekteve infrastrukturore kyçe në sektorët për transport, energji dhe digitalizim.

Sfidat për implementim

- Kriza e prolonguar politike (2015-2017) e ngadalësoi rritjen ekonomike dhe e zvogëloi besimin e investitorëve (vendorë dhe të huaj).
- Kapaciteti i ulët administrativ për zbatimin e plotë të projekteve infrastrukturore kryesore publike.
- Mungesa e mundësive fitimprurëse në sektorin korporativ dhe sektorin NVM si rezultat i nivelit të lartë të detyrimit, kapacitetit të ulët për përgatitjen e projekteve fitimprurëse dhe likuiditetit të madh në treg të siguruar prej institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare zhvillimore.
- Subjektet me investime të huaja zakonisht janë të shërbyera mirë nga banka amë me çka angazhimi i Bankës kufizohet në transaksione të vogla me shpenzime transaksionare joproporcionale.
- Qasje e gjerë dhe çmime konkurruese për financim prej INF për projekte me garanci shtetërore.
- Përfaqësim i lartë i Emerald dhe Natura 2000 lokacione (30% përfaqësim i vendit) i kombinuar me kapitalin e ulët pronësor të investitorëve në energjinë e ripërtëritshme i kufizon mundësitë e Bankës për investime të drejtpërdrejta në HCV.

Leksione kryesore dhe hapa të ardhshëm

- Gjatë krizës politike, u fokusua vetëm në mbështetjen e investimeve private të drejtpërdrejta apo përmes linjave kreditore për IPF me qëllim që qëndrueshmërisë së zhvillimit të sektorit privat.
- Plotësimi i investimeve në infrastrukturën publike përmes ndërtimit intensiv të kapacitetit institucional, psh. mbështetjen për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, bashkëpunimin e afërt me INF të tjera të cilat kontribuojnë në proces.
- Shfrytëzimi i granteve bashkëinvestuese dhe BT dhe me qëllim që në mënyrë selektive të përmirësohet konkurrenca e produkteve kreditore të BERZH, siç janë këshillimi i NVM për përmirësimin e menaxhimit korporativ dhe standardet e punës si dhe ndërmarrja e më shumë rreziqeve (psh. mezanina, ndarja e përshtatshme e rreziqeve lidhur me portfolion).
- Përfaqësimi për pjesëmarrje të rritur të sektorit privat (psh. ndarja e shërbimeve komunale) në ofruesit kyç të shërbimeve për t'u zgjeruar përfshirja potenciale për angazhimin e bankës.
- Të vazhdojë shfrytëzimi i pranisë lokale të BERZH-it dhe aftësia për kombinimin e investimeve dhe mjeteve të donatorëve (psh. WBIF), përmes ofrimit të ndihmës teknike të financuar prej donatorëve që të përmirësohet qasja, të vazhdohet me ofrimin e huave korporative për ndërmarrjet publike për shërbim (psh. MEPSO).
- Mbështetja eTEGJ jostabile, mbështetja e rehabilitimit të HE ekzistuese (një e treta e prodhimit të tanishëm të energjisë elektrike në vend) si edhe shqyrtimi i projekteve të tjera për energji ripërtëritëse për qëllime të diversifikacionit të burimeve energjetike.

2. Konteksti ekonomik



European Bank
for Reconstruction and Development

2.1 . Konteksti makroekonomik dhe parashikimi për periudhën e cila e përfshin strategjinë

Maqedonia e Veriut–Tregues kryesorë makroekonomikë

	2014	2015	2016	2017	2018 përq
Rritja e BPV-së (% y-o-y)	3.6	3.9	2.8	0.2	2.0
CPI inflacion (% gusht)	-0.3	-0.3	-0.2	1.4	1.4
Bilanci qeveritar (% nga BPV)	-4.2	-3.5	-2.6	-2.7	-2.7
Bilanci vijues (% nga BPV)	-0.6	-1.9	-2.9	-0.8	-1.0
Neto IHD (% nga BPV)	2.3	2.3	3.3	1.8	2.0
Borxhi i jashtëm (% nga BPV)	70.0	69.3	74.7	73.6	79.9
Bruto rezerva (% nga BPV)	28.5	24.9	27.1	23.3	25.8
Bruto borxh i përgjithshëm qeveritar (% nga BPV)	45.8	46.7	47.8	48.0	50.0
Papunësia (% popullata)	28.0	26.1	23.7	22.4	20.8
BPV Nominal (miliarda \$)	11.4	10.1	10.7	11.3	12.4

- **Maqedonia e Veriut pati rritje mesatare të BPV-së dhe mjedis makroekonomik stabil në 15 vitet e kaluara.** Rritja mesatare në periudhën 2011-16 ka qenë 2,8%, në krahasim me 1,4% në BE, që sugjeron se Maqedonia e Veriut gradualisht e arrin standardin jetësor të BE-së. Vendi kishte shkallë relativisht të ulët të rritjes në periudhën para krizës 2001-08 prej vetëm 3,4%, që ishte nën treguesit rajonal krahasues. Periudha pas krizës 2009-16 u karakterizua me recesion të dyfishtë prej 0,4% në vitin 2009 dhe 0,5% në vitin 2012, e shoqëruar me disa vite të mira relative në periudhën 2013-15, me shkallë mesatare të rritjes prej 3,5%.
- **Rritja u ul në pothuajse zero në vitin 2017.** Kriza e prolonguar politike, e cila filloi në vitin 2015, ndërsa eskaloj në gjysmën e parë të vitit 2017, ndikoi ndaj rezultateve ekonomike të vendit me ndikim të matshëm negativ ndaj besimit dhe investimeve. Ekonomia ishte në recesion në gjysmën e parë të vitit 2017, me rimëkëmbje të vogël në gjysmën e dytë të vitit, kështu që rritja e realizuar për këtë vit në tërësi ishte pothuajse zero. Në një moment kriza paraqiste kanosje për stabilitetin e kursit të valutës lokale në raport me euron dhe Banka Qendrore duhej të reagojë ndaj presioneve ndaj valutës gjatë vitit 2016 me rritjen e shkallës referente të interesit në 4%. Megjithatë, në shkurt të vitit 2017, Banka Qendrore përsëri e uli shkallën e nivelit të saj afatgjatë prej 3,25%. Shkalla u zvogëlua në mënyrë plotësuese në vitin 2018 në 2.5 % aktual. Inflacioni për më shumë vjet është i ulët, deficitit fiskal u zvogëlua nën 3% të BPV-së, ndërsa nivelet e borxhit publik janë mesatare edhe pse ngadalë po rriten.
- **Përmirësimi i mëtejshëm është i mundshëm në afat të shkurtër.** Në vitin 2018 filloi rimëkëmbja e ndihmuar nga stabiliteti politik dhe ndikimi prej rritjes së pagës minimale dhe masat e tjera për mbrojtje sociale ndaj konsumit personal, si dhe intensifikimin e rritjes së eksportit, me normë të vlerësuar prej 2.0%. Kreditimi i ekonomisë pritet të rritet me lehtësimin e kushteve për sigurimin e huave në kushte të politikës monetare të përshtatshme. Gjithashtu pritet rritja e mëtejshme e eksportit si rezultat i përfundimit të perspektivave ekonomike në BE e cila është partnerja kryesore tregtare e vendit. Si rezultat i kësaj, parashikimi për rritje në vitin 2019 3,0% në vitin nën supozimin për stabilitet politik të vazhdueshëm, zhblllokimin e reformave të mëtejme dhe ardhjen e investimeve shumë të nevojshme me shkallë të ngjashme të rritjes viteve të ardhshme.

2. Konteksti ekonomik

2.2 . Sfidat kryesore për tranzicionin




European Bank
for Reconstruction and Development

Konkurrenca (5.73)

- **Më konkurrentja midis gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB-6)**, me rezultate të shkëlqyera në rangimin e Bankës Botërore për udhëheqjen e lehtë të biznesit – e 10-ta midis 190 vendeve. Zbatimi i marrëveshjeve dhe zgjidhja e josolvencës janë sferat më problematike.
- **Produktiviteti** është nën mesataren për rajonin WB-6 dhe larg nën standardet e BE-së.
- **Konkurrenca jolojale e ekonomisë gri** është theksuar si pengesa më e madhe për udhëheqjen e biznesit nga 26% e të anketuarve në **HKBNP**. Ekonomia gri vlerësohet se është midis 25% dhe 50% nga BPV.
- Vendi është vlerësuar si **ekonomi e njohurive me nivel të mesëm**, e kufizuar prej qasjes së dobët të aftësive. 14% e kompanive në **HKBNP** e theksojnë fuqinë punëtore me arsim jopërkatës si pengesë serioze në punën afariste.
- Maqedonia e Veriut është duke u ballafaquar me **hendek të mesëm** në pesë dimensionet prej **zhvillimit të NVM**. Financimi jobankar dhe aftësitë dhe standardet afariste janë mjaft problematike.
- Zbatimi i dobët i **politikës për konkurrencë**.

Udhëheqje e lehtë e biznesit
(rangimi mes 190 ekonomive)



Burimi: Doing Business raport i Bankës Botërore, 2019

Menaxhim i mirë (5.78)

- **Menaxhimi publik** ishte nën **ndikimin negativ** të jostabilitetit politik, qeverisjes së dobët të së drejtës dhe kontrollit jopërkatës të korrupsionit.
- **Reformat e suksesshme administrative** viteve të kaluara në mënyrë të konsiderueshme i zvogëluar stërngarkimet administrative dhe rregullatore për kompanitë, por akoma ka një përqendrim të caktuar në sferën e zbatimit të marrëveshjeve.
- **Perceptimet për korrupsion dukshëm u përqësuan viteve të fundit**. Vendi tani është radhitur në pozitën 93 prej 180 vendeve, në krahasim me pozitën e 66 prej para tre vitesh, me siguri për shkak të skandalit me përgjimet i cili zbuloi keqpërdorime masovike të detyrës nga nëpunësit publik.
- **Lidhjet politike** shumë i konsiderojnë si çelës për sukses në jetë; 45% e të anketuarve në LITS III e vlerësojnë këtë faktor si të rëndësishëm prej angazhimeve të tyre dhe punës së mundimshme apo inteligjencë dhe aftësi.
- **Menaxhimi korporativ** është më i mirë në Maqedoninë e Veriut në krahasim me shumë vende të tjera në rajon. Akoma janë të pranishme dobësi në sferën e mbikëqyrjes dhe transparencës së këshillave korporative.

Lidhjet politike si faktor suksesi




Burimi: Hulumtimi i jetës në tranzicion (LITS)

Ekologji (4.93)

- Pjesa më e madhe e energjisë elektrike (58%) prodhohet në **termo centrale të vjetruara** me efikasitet prej 32% të cilat punojnë me thëngjill të cilësisë së ulët. Energjia e prodhuar nga hidrocentralet është 33%.
- Ekziston mundësi e konsiderueshme për përmirësimin e efikasitetit në termocentralet ekzistuese pasi Maqedonia e Veriut e miratoi Planin e tretë aksional për **efikasitetin energjetik** në korrik të vitit 2017.
- **Burime të tjera të ripërtëritshme të energjisë**, veçanërisht hidroenergja dhe energjia solare, pritet të bëhen më të rëndësishme në prodhimin e energjisë elektrike. Megjithatë, Plani kombëtar aksional për energji ripërtëritëse (PKAER) në është i dizajnuar për t'u plotësuar qëllimi i obligueshëm me ligj i vendit për energji ripërtëritëse prej 28% dhe në vend të kësaj është paraparë qëllim prej vetëm 23.9% në vitin 2020.
- Vendi për momentin mbështet projekte për energji ripërtëritëse me **tarifa të autorizuar** përmes MFEE me operatorin e tregut. Tranzicioni ndaj qasjes "Marrëveshjes për dallim" do të mundësojë komercializim të mëtejshëm dhe rritjen e penetrimit të energjisë ripërtëritëse.

Ndotja e ajrit PM2.5



Burimi: Banka Botërore, 2015

2. Konteksti ekonomik

2.2 . Sfidat kryesore për tranzicionin




European Bank
for Reconstruction and Development

Inkluzioni (5.61)

- Papunësia e lartë e të rinjve dhe pjesëmarrja e ulët në tregun e punës tek gratë** i paraqesin kanosjet kryesore për dukjet për rritjen inkluzive.
- Niveli i lartë i **papunësisë së të rinjve**, afër 50% - 24% e të rinjve nuk janë përfshirë në arsim, punësim apo trajnim.
- Mospërputhja e aftësive** është një prej shtytësve kryesorë të mosaktivitetit të të rinjve. Në HKBPN V, 14% e të anketuarve vlerësojnë se fuqia punëtore me arsim jopërkatës është pengesë kryesore apo serioze për rritjen.
- Mospërputhja e aftësive nuk është përkeqësuar prej **mundësive të dobëta për mësim në vendin e punës**. Edhe pse ekzistojnë rregullativa, mekanizmat për implementim nuk funksionojnë në mënyrë efektive.
- Pjesëmarrja e grave në ekonomi** është mjaft e ulët në krahasim me burrat (42% gra kundrejt 68% burra).
- Hendeqe të konsiderueshme në inkluzionin gjinor** në pikëpamje të qasjes drejt financave dhe praktikave të punës. Kjo është akoma më e shprehur si rezultat i stereotipave të fuqishme për rolin tradicional të gruas në shoqëri.

Papunësia tek të rinjtë, % prej fuqisë punëtore të përgjithshme në moshë prej 15-24,(2017)




Burimi: Tregues të zhvillimit botërore, Banka Botërore, 2018

Rezistenca (5.72)

- Stabiliteti i sektorit financiar është i fuqishëm**, i mbështetur prej **politikës stabile monetare**. Banka qendrore e ruan kursin devizor fiks në raport me euron (paraprakisht në raport me markën gjermane) mbi 20 vjet.
- Sektori bankar është kapitalizuar mirë, por do t'i vinte mirë konsolidim plotësues**. Përshtatshmëria e kapitalit është 16,3% (nga mesi i vitit 2018), në nivel të njëjtë me sistemet e tjera bankare në BP-6 dhe larg mbi kërkesat rregullatore prej 8%.
- Huat jofunksionale** u ulën në 5% nga mesi i vitit 2018 pas periudhës prej tre deri në katër vitet paraprake kur ruhet niveli stabil prej rreth 10% deri në 11% prej huave të përgjithshme, që është reflektim i masave të paracakohshme për shlyerjen e huave jofunksionale për të cilat janë bërë rezervime të plota prej periudhë më të gjatë se dy vjet.
- Euroizimi është mesatar** dhe në masë të madhe stabil: rreth 40% e huave dhe 40% e depozitave janë denominuar në valutë të huaj. Banka qendrore në mënyrë efektive përdor masa makroprudente për ta kontrolluar euroizimin e mëtejshëm.
- Zhvillimi i shërbimeve **financiare jobankare** është në zhvillim, ndërsa kapitalizimi tregtar i bursave është i ulët.

Hua jofunksionale, % prej huave të përgjithshme(2017)




Burimi: Autoritetet kompetare, 2018

Integrimi (6.09)

- Transparenca tregtare pesëvjeçare mesatare** e Maqedonisë së Veriut [(eksporti + importi)/BPV] është 107%, që është larg mbi mesataren e BERZH-it prej 92% dhe afër mesatares së BE-së (120%). Vendi ka qasje jotarifore në BE dhe në vendet e saj fqinje WB-6 në kuadër të CEFTA. Megjithatë nevojitet progres i mëtejshëm për uljen e barrierave pa tarifa.
- Niveli i IHD është i ulët**; Megjithatë, politikat të cilat janë të prira për bizneset viteve të kaluara realizuan rezultate pozitive duke tërhequr investime në sektorë të rëndësishëm siç është ai për pjesë për automobila.
- Në indeksin global të konkurrencës së FEB cilësia e **infrastrukturës transportuese** është ranguar në nivel më të lartë në mesatare në krahasim me vendet e tjera të WB-6, me ç'rast rezultati më i lartë është realizuar në komunikacionin ajror dhe më i ulëti në sektorin hekurudhor. Korridori rrugor X ka përfunduar, ndërsa korridori VIII është në ndërtim.
- Integrimi energjetik** ndërkufitar ngadalë është duke u përmirësuar. Në vijim është ndërtimi i 400 kV të transportuesit interkonektues me Shqipërinë.

Transparenca tregtare, % BPV (2017)



Burimi: Pasqyra ekonomike të FMN, 2018; përlogaritje të autorit

3. Prioritetet e qeverisë dhe angazhimi i palëve të interesuara

3.1. Prioritete reformuese qeveritare

Programi për reforma ekonomike 2016-2020 (i përgatitur në pajtim me Programin e Qeverisë 2017-2020, Strategjinë fiskale në afat të mesëm dhe dokumente të tjera strategjike) i përcakton sferat vijuese për të gjitha reformat strukturore me qëllim të trasimit të rrugës për inkuadrim në BE.

- **Menaxhimi me financa publike:** kornizë e përfshirë buxhetore, sistem i integruar TI për financa publike, përmirësimin e furnizimeve publike, modernizimin e sistemit tatimor, procedura të përmirësuara për kontroll doganor, administratë tatimore dhe kontroll financiar.
- **Reforma energjetike:** diversifikimi i prodhimit të energjisë, implementimi i masave “të buta” në rajonin e Ballkanit Perëndimor duke e përfshirë edhe zhvillimin e tregut, liberalizimin dhe alokimin/ribilancimin e kapacitetit ndërkufitar, masa vepruese për energji të qëndrueshme dhe ndryshime klimatike, duke e përfshirë edhe zhvillimin e energjive të ripërtëritshme dhe zgjidhjet për efikasitet energjetik.
- **Ristrukturimi i tregut transportues:** Efikasitet i përmirësuar, siguri dhe ndikim ndaj mjedisit jetësor të sektorit; zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit rrugor dhe hekurudhor përgjatë korridoreve X dhe VIII si bazë për diversifikimin dhe integrimin e zinxhirëve rajonal të vlerave.
- **Mbështetja e tregtisë, IHD dhe investimeve vendore:** zhvillimi i industrisë dhe sektorit shërbyes me fokus në agrobiznesin, turizmin dhe hotelierinë; lehtësimi i progresit teknologjik, lidhjet dhe hulumtimet dhe zhvillimi për qëllime të përmirësimit të konkurrencës; masa për lehtësimin e tregut dhe liberalizimit në kontekst të CEFTA, OBT dhe marrëveshje të tjera tregtare dhe investuese.
- **Klima e biznesit dhe masa për ballafaqim me ekonominë gri:** zhvillimi i portalit kombëtar e-Shërbime, përmirësimi i shërbimeve administrative, mbështetja e NVM, rritja e transparencës dhe parashikimit të rrethimit rregullator.
- **Aftësi të përmirësuara dhe treg i punës:** lidhshmëria e përmirësuar midis nevojave të sektorit arsimor dhe privat, zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të kualifikimeve, reformave në APT dhe programe për punësimin aktiv veçanërisht për të rinjtë.

3.2. Sferat reformuese të BERZH në masë të madhe janë të harmonizuara me autoritetet

- Konsolidimi dhe transformimi i pronësisë në **sektorin bankar**.
- **Zhvillimi i tregut të kapitalit** dhe qasje e përmirësuar në financimin jobankar (duke përfshirë faktoring dhe lizing)
- Kornizë rregullatore dhe institucionale për **energji ripërtëritëse dhe efikasitet energjetik**
- Kërkesë për produktet e **Qyteteve të gjelbra** të jenë në dispozicion për qytetet me më pak se 100.000 banorë.
- Implementimi dhe shpërndarja e Strategjisë për **digitalizim**.
- **Punësim dhe aftësi** të përmirësuara të të rinjve, grave dhe popullatës që jeton në rajone të cilat nuk mbulohen mjaftueshëm
- Kapacitete të rritura në pjesën e **Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës**
- Promovimi i PPP për distribuimin e gazit dhe menaxhimit me mbeturina të ngurta
- **Siguri** e rritur dhe qëndrueshmëri ekologjike në **trafik**
- Zbatimi i **parimeve për furnizime publike** të BE/OBT

3.3. Mesazhe kryesore prej shoqërisë qytetare për BERZH-in

- **Menaxhimi dhe Antikorrupsioni:** angazhim i përfshirë i BERZH për përmirësimin e menaxhimit me kompani publike dhe private dhe luftë kundër korrupsionit përmes praktikave të furnizimeve transparente
- **Mbrojtja e natyrës:** angazhim i përfshirë i BERZH-it në ndërtimin e kapacitetit kombëtar për mbrojtjen e natyrës dhe ruajtjen e mjedisit jetësor (psh. rritja e vetëdijes për Natura 2000).
- **Standarde ekologjike në rajonet e mbrojtura:** zhvillimi i kriterëve ekologjike për vlerësimin e investimeve të cilat duhet të shfrytëzohen si vegël referente për sjelljen e vendimeve për koncesione dhe projekte kryesore të infrastrukturës (p.sh. Transport dhe energji).
- **Qytet i gjelbër dhe efikasitet energjetik:** kërkesë të shqyrtohet mundësia që qyteti i Ohrit të kyçet në Kornizën e qyteteve të gjelbra të Bankës dhe të krijohen linja kreditore për efikasitet energjetik të cilat duhet të jenë në dispozicion për shoqatat e banorëve.
- **Ekonomia e gjelbër:** fokus i rritur i burimeve ripërtëritëse të energjisë (psh. Me erë dhe solare) dhe mbështetje e kornizës rregullatore energjetike.
- **Angazhim dhe menaxhim i palëve të interesuara:** rëndësia e ruajtjes së konsultimeve të rëndësishme publike për pjesëmarrjen e Bankës në projekte hidrologjike dhe të xehetarisë.

4. Definimi i prioriteteve strategjike për Maqedoninë e Veriut



European Bank
for Reconstruction and Development

Çfarë duhet ndryshuar? (Pjesa 2)	A mund të ndryshojë? (Pjesa 3)	Çfarë mund të bëjë banka? (Pjesa 4)	Prioritete strategjike (2018-2023)	Çfarë duam të shohim në vitin 2023
- Produktiviteti i ulët në sektorin privat. - Kapacitete të pamjaftueshme korporative për miratimin e proceseve inovative dhe integritetit të kufizuar në zinxhirin evropian të furnizimeve? Sisteme globale të vlerave (GVCs). - Barriera të larta për qasje në financa veçanërisht për NVM, e vështirësuar për shkak të mungesës së institucioneve financiare jobankare - Mungesa e aftësive afariste dhe standardeve në sektorin korporativ; menaxhimi i dobët korporativ. - Mospërputhje e konsiderueshme e aftësive të rinjve që e kanë përfunduar arsimin e tyre dhe pjesëmarrja e ulët e grave. - Ekonomi e madhe gri dhe zbatim i dobët i politikave për konkurrencë.	- Impuls i fuqishëm për zbatimin e reformave ekonomike (qeveria e re pro-reformuese e koalicionit, Programi për reforma ekonomike për përshejtimin e rrugës drejt BE-së). - Inovacionet, progresi teknologjik dhe zinxhirët e vlerave janë prioritete kryesore të qeverisë. - Marrëveshja për stabilizim dhe asociim me BE-në si bazë e jashtme për integrim në zinxhirin global dhe rajonal CEFTA. - Legjislative kryesore për klimë të mirë biznesi është vendosur (pozita e 10-të në WB Doing Business), por nuk zbatohet mjaftueshëm. - Prioritet qeveritar kyç është punësimi i të rinjve. - E-menaxhimi si qëllim që realizohet lehtë është prioritet i lartë në agjendën e organeve kompetente.	- Produkte të përshtatura mirë për mbështetjen e MSP dhe korporatave (programi për konkurrencë i NVM, linja kreditore, ENEF) - Përvoja në promovimin e produkteve financiare jobankare, mbështetje për ndërmarrjen kapitalo/kuazi-kapitalo të rrezeve (PE/VC) dhe ndërtimi i kapaciteteve për zhvillimin e tregut të kapitalit. - Instrumentet efektive do të ndihmojnë të rriten aftësitë korporative dhe afariste (WiB, ASB, Blue Ribbon) - Rezultate të dëshmuara në zhvillimin e zgjidhjeve për përmirësimin e aftësive në vendin e punës së bashku me klientët korporativ. - Rezultate të shkëlqyera në sigurimin e mbështetjes së menaxhimit të mirë ekonomik (Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës).	<i>Mbështetja e konkurrencës përmes përmirësimit të zinxhirit të vlerave, sendërtimi i aftësive të fuqisë punëtore dhe përforcimi i menaxhimit</i>	- Zinxhirë të përmirësuar të vlerave dhe lidhjeve përmes produkteve të përmirësuar dhe proceseve inovative dhe standardeve operative dhe aftësive afariste - Numër i rritur i produkteve dhe shërbimeve financiare të llojllojshme jobankare - Qasje më të mirë në punësimin cilësor dhe aftësitë me fokus te gratë dhe burrat e rinj - Konkurrencë e rritur dhe kushte të garantuara të barabarta për udhëheqjen e biznesit dhe pjesëmarrja në sektorin privat
- Cilësi e dobët e infrastrukturës transportuese, veçanërisht rrugëve dhe hekurudhave. - Integrim i ulët në tregjet rajonale energjetike çon drejt rritjes së çmimeve të energjisë. - Penetrim i ulët i TIK (17,8% prej popullatës shfrytëzon shërbime me shtrirje të gjerë). - Zbatimi i pamjaftueshëm dhe zbatimi i kornizës së sigurt investuese i kufizon IHD.	- Korridore Panevropiane dhe agjenda për lidhjen transportuese rajonale, TEN-T janë faktorët kyç për mbështetje. - Janë investuar angazhime të konsiderueshme për gasifikim (janë nënshkruar Memorandume për mirëkuptim me vendet fqinje). - Lidhja digjitale është prioritet kryesor i qeverisë, duke përfshirë nisma për aftësi TIK. - Interes i fuqishëm për zhvillimin e lidhjes së butë në drejtim të përafërimit drejt BE-së dhe harmonizimit të marrëveshjeve rajonale dhe tregtare investuese.	- Rezultatet e shkëlqyera të BERZH dhe partneritetet e vazhdueshme me organet kompetente për sigurimin e mjeteve për financim me qëllim që të ndihmojë të ulët hendeku infrastrukturor dhe energjetik me zhvillimin e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe uljes së rrezeve lidhur me projekte të mëdha dhe afatgjata. - Përvojë e rritur në këshillim për Strategji kombëtare për shërbime/digjitalizim me shtrirje të gjerë. - Mbështetje dhe përvojë e fuqishme plotësuese e BERZH në stimulimin e bashkëpunimit të botë rajonal (këshilla rajonale investuese, regjistra ekonomik).	<i>Përforcimi i integritetit rajonal, lidhja e butë dhe mbështetja e përafërimit drejt BE-së</i>	- Cilësi e përmirësuar dhe lidhje e infrastrukturës kyçe - Nivele të rritura të lidhjes me shtrirje të gjerë dhe digjitalizimit - Lidhje e përmirësuar “e butë” dhe praktika afariste të harmonizuara
- Ekonomi më intensive energjetike në Ballkanin Perëndimor, varësi e lartë prej thëngjillit dhe importit të naftës. - Mungesë e ujit (psh. agrobiznesi) dhe ndjeshmëri ndaj ndryshimeve klimaterike (psh. vërshime) - Cilësi e dobët e ujërave (63% humbje të ujit) dhe sisteme të pamjaftueshme për trajtimin e ujërave të zeza.	- Përkushtim i qeverisë drejt realizimit të kontributeve kombëtare (NDCs) në pajtim me Marrëveshjen e Parisit për ndryshime klimaterike (KOP21) dhe qasjen drejt BE-së. - Dritare e mundësive për energji ripërtëritëse - Potencial i rritur për kursimin e energjisë dhe kërkesë për rritjen e efikasitetit energjetik, miratimi i Planit të dytë veprues kombëtar për efikasitetin energjetik është në vijim.	- Përvojë e konsiderueshme në mbështetjen e kornizës rregullatore dhe institucionale për energji ripërtëritëse dhe efikasitet energjetik. - Produkte me qëllim të caktuar për financimin e investimeve për tranzicionin drejt energjisë së gjelbër përmes linjave të veçanta kreditore. - Përvojë e konsiderueshme në projekte komunale me qëllime të qarta lidhur me ekologjinë dhe efikasitetin e resurseve me qasje të mirë drejt granteve për financim.	<i>Mbështetja e tranzicionit drejt „ekonomisë së gjelbër“ përmes një miksi më të qëndrueshëm energjetik dhe efikasitet më të madh të resurseve</i>	- Kapacitet i rritur për energji ripërtëritëse, miksi më i ndryshëm energjetik dhe pjesëmarrje më e madhe në sektorin privat në sektorin energjetik - Efikasitet i rritur energjetik dhe efikasitet i burimeve - Infrastrukturë e përmirësuar ekologjike (ujë, mbeturina, ujëra të zeza) në nivel lokal dhe komunal

5. Kornizë e aktiviteteve dhe rezultateve

Prioriteti 1: Mbështetja e konkurrencës dhe inkluzionit përmes përmirësimit të zinxhirëve të vlerave, zhvillimi i aftësive të fuqisë punëtore dhe përforsimi i menaxhimit

Qëllime kryesore (Rezultate)	Aktivite (Rezultate)	Tregues për ndjekje
Zinxhirë të përmirësuar të vlerave dhe lidhjeve përmes standardeve të përmirësuara operative dhe aftësive afariste	- Sigurimi i financimit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë (duke përfshirë ndarjen e rreziqeve) dhe këshillimin e korporatave dhe NVM me fokus në TIK, agrobiznes, prodhimtari, patundshmërinë dhe turizmin. - Mbështetja e kompanive vendore në miratimin e praktikave inovative dhe teknologjive, rritjen e produktivitetit dhe përhapjen në tregjet rajonale përmes financimit të drejtpërdrejt dhe këshillimit të orientuar afatgjatë (përmes Programit për mbështetjen e konkurrencës së NVM dhe programit Shirit i kaltër). - Financimi përmes IHD dhe investitorëve kryesorë vendorë me fokus në integrimin në zinxhirët rajonal të vlerave dhe transfetreve të inovacioneve furnizuesve lokalë. Hua me qëllim të caktuar për financim dhe këshillime teknike për sektorin e agrobiznesit - Mbështetje përmes investimeve të klientëve korporativ (përfshirë edhe me vendet e BE-së siç janë Bullgaria dhe Greqia.	- Nr. i klientëve që vendosin teknologji të reja - Numri i klientëve me konkurrencë të rritur përmes zgjerimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të tyre përpunuese
Numër i rritur i produkteve dhe shërbimeve të llojllojshme jobankare financiare	- Mbështetja e konsolidimit të sektorit bankar përmes investimeve kapitale - Zgjerimi i spektrit të produkteve dhe shërbimeve për rritjen e qasjes në financimin jobankar, duke përfshirë edhe financime mezanin dhe lëshimin e obligacioneve (shqyrtimin e mënyrave të kapitalizimit të punës së Bankës me tregjet rajonale të kapitalit) e obligacioneve. - Pjesëmarrja në fazat e hershme të përgatitjes së programit rajonal për zhvillimin e ndërmarrjeve përmes Programit Akceleratori rajonal. - Mbështetja e faktoring përmes këshillimit lidhur me politikat të cilat lidhen me kornizën juridike dhe rregullatore. - Përmirësimi i programit për financim tregtar, përfshirë edhe përmes trajnimit Trade Ready) për mbështetjen e përhapjes së tregjeve rajonale dhe promovimin e eksportit të kompanive lokale.	Numër i përgjithshëm i produkteve/shërbimeve jobankare financiare të cilat janë vendosur, përhapur apo zhvilluar
Qasje më e mirë në punësimin cilësor dhe aftësitë me fokus tek gratë dhe burrat e rinj	- Zhvillimi i trajnimeve profesionale së bashku me klientët korporativ dedikuar për përmirësimin e mundësive për punësim dhe aftësi (për të rinj, gra si edhe popullatë që jeton në zona të cilat nuk mbulohen në mënyrë të mjaftueshme). - Ndjekjen e parimeve të furnizimeve inkluzive me qëllim të përmirësimit të mundësive për punësim dhe aftësitë për persona të rinj dhe gra. - Bashkëpunim me klientë publikë në zhvillimin e programeve për trajnim dhe promovimin dhe krijimin e vendeve të punës si pjesë e furnizimeve.	- Nr. i personave (të rinj/gra/popullatë lokale në pajtim me qëllimet) që kanë fituar aftësi të reja/të përmirësuara si rezultat i trajnimeve - Numri i trajnimeve të realizuara
Korniza të përmirësuara kombëtare për menaxhim korporativ dhe konkurrencë e rritur	- Mbështetja e Këshillit për Mbikëqyrje Inspektuese në zbatimin e Ligjit të ri për mbikëqyrje inspektuese - Ndërtimi i kapaciteteve të Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës dhe mbështetjen në krijimin e Forumit rajonal të komisioneve për mbrojtjen e konkurrencës me qëllim të ndarjes të praktikave më të mira. - Promovimi i involvimit të sektorit privat përmes PPP në infrastrukturën energjetike dhe komunale. - Punë me ndërmarrjet publike të zgjedhura për përmirësimin e transparencës financiare dhe menaxhimin korporativ përmes PVMK (Planeve Vepruese për menaxhim korporative). - Promovimi i shfrytëzimit të platformave për e-furnizime	Përmirësime juridike/rregullatore/institucionale për përmirësimin e konkurrencës

5. Kornizë e aktiviteteve dhe rezultateve

Prioriteti 2: Përforcimi i integritetit rajonal, “lidhje e butë” dhe mbështetje e përafrimit drejt BE-së

Qëllime kryesore (Rezultate)	Aktivitete (Rezultate)	Tregues për ndjekje
Lidhje e përmirësuar dhe integrimi i infrastrukturës kryesore transportuese dhe energjetike	- Përshpejtimi i përfundimit të rrjeteve kryesore transportuese sipas TEN-T: - Financimi dhe siguri i kështillimit për finalizimin e hekurudhës Korridori panevropian VIII; - Financimi i akteve të fundit rrugore nga Korridori VIII dhe lidhja e rrugëve rajonale; - Mbështetja e vendosjes së sistemeve moderne për pagesën e taksës për rrugë në akset rrugore Korridori VIII dhe X. - Mobilizimi i fondeve për bashkëpunim teknik për mbështetjen e përgatitjes dhe implementimit të projekteve, me fokus në dizajnin detajues, mbështetjen e Njësive për Implementimin e Projekteve (NJIP) dhe mbikëqyrjen e marrëveshjeve. - Sigurimi i ndihmës teknike për privatizimin e ndërmarrjet për transportin hekurudhor. - Mbështetja e zhvillimit të planit korporativ për përmirësimin e efikasitetit operativ të ndërmarrjes për rrugë shtetërore përmes përfundimit të praktikave të tij për mirëmbajtje dhe pagesën e të ardhurave. - Mbështetja e vendosjes së agjencisë për siguri në rrugë, duke e përfshirë edhe bazën e të dhënave për aksidente dhe rishikimin e sigurisë në rrugë si dhe rregullave dhe procedurave për kryerjen e inspektimit në bashkëpunim me IFN të tjera për financimin e korridoreve transportuese. - Sigurimi i investimeve dhe interkonektorëve për gaz dhe rrjeteve për përçimin/distribuimin e gazit. - Përmirësimi i rezistencës së infrastrukturës transportuese dhe energjetike lidhur me ndryshimet klimaterike dhe promovimin e dekarbonizimit përmes përmirësimit teknologjik me qëllim të emetimit të dëmshme.	Rrjeti infrastrukturor i targetuar është zgjeruar që matet me rritjen e kapacitetit të rrjeteve
Nivele të rritura të lidhjes me shtrirje të gjerë dhe digjitalizimit	- Kështillimi lidhur me politikat për implementimin e agjendës për digjitalizim. - Sigurimi i financimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë dhe kështillimi për digjitalizim dhe adaptim TIK të sektorit privat me fokus në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. - Mbështetja e nismave për e-qeveri për shërbime G2B (për shembull, studime të fizibilitetit dhe/apo plane vepruese, ndërtimin e kapaciteteve të agjencive kyçe). - Mbështetja e Agjendës digjitale për Ballkanin Perëndimor e promovuar nga BE-ja përmes kështillimit dhe financimit	Numri/vëllimi i huave të siguruar për NVM/ nën-hua për digjitalizim
Përmirësimi i lidhjes së “butë” dhe praktika afariste të harmonizuara	- Mbështetja e dakordimit të marrëveshjeve për vendkalime të përbashkëta kufitare me shtetet fqinje (për shembull, vendkalimi kufitar hekurudhor, kontrolli i përbashkët kufitar) në bashkëpunim me IFN të tjera për financimin e korridoreve transportuese - Mbështetja e zhvillimit të platformave rajonale të biznesit (regjistra rajonal ekonomik), dhe lehtësimi i harmonizimit të praktikave afariste të ngjashme. - Mbështetja e Qeverisë në respektimin e rregullave të OBT (Organizatës Botërore të Tregtisë) duke e përfshirë edhe harmonizimin e legjislaturës ekzistuese. - Mbështetja e qasjes ndaj BE-së përmes ndihmës teknike dhe reformat ligjore në sektorin për infrastrukturë (transport, energjetikë, infrastrukturë komunale dhe ekologjike).	Korniza ligjore, institucionale apo rregullatore për integrimin e përmirësuar

5. Kornizë e aktiviteteve dhe rezultateve

Prioriteti 3: Mbështetje e tranzicionit ndaj “ekonomisë së gjelbër” përmes miksit më të qëndrueshëm energjetik dhe efikasitet më të madh të resurseve

Qëllime kryesore (Rezultate)	Aktivitete (Rezultate)	Tregues të ndjekjes
Kapacitet i rritur për energjinë ripërtëritëse, miks energjetik më i ndryshëm dhe pjesëmarrje më e madhe e sektorit privat në sektorin energjetik	- Sigurimi i financave për projekte për energji ripërtëritëse përmes financimit të drejtpërdrejt dhe programeve për ndarjen e rreziqeve si edhe përmes këshillimit për përcaktimin e potencialit të teknologjive për energji ripërtëritëse. - Angazhimi përmes politikave për mbështetjen e tranzicionit prej tarifave të autorizuar drejt modelit të bazuar në ankande, duke filluar me ndihmë teknike për sisteme konkurruese të ankandëve për projekte për energji solare dhe me erë. - Sigurimi i ndihmës financiare dhe teknike për kapacitetet e Hidrocentraleve të reja të mëdha dhe mbështetjen e ripërtëritjes dhe përmirësimit të rezistencës ndaj ndryshimeve klimaterike të hidrocentraleve ekzistuese. - Përmirësimi i kalimit drejt burimeve më të pastra për prodhimin e energjisë duke përfshirë kalimin nga thëngjilli në gaz, i shoqëruar me ndihmë teknike për zhvillimin e gazifikimit.	Gjithsej kapacitete të instaluar për energji elektrike prej burimeve ripërtëritëse (MW)
Efikasitet i rritur energjetik dhe efikasitet i resurseve	- Sigurimi i linjave kreditore për efikasitet energjetik dhe efikasitet të resurseve përmes bankave partnere prej kornizës rajonale REEP+ me fokus në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe sektorin popullatë. - Mbështetja e investimeve private në industrinë për riciklim dhe investime prej kompanive private në zgjidhje për efikasitetin e resurseve. - Mbështetja e zhvillimit të sektorit për mbeturina të ngurta në të gjithë ciklin e menaxhimit me mbeturina, duke filluar prej zgjidhjeve për grumbullim, përmes riciklimit e deri në shndërrimin e mbeturinave në energji.	- Vëllimi i huave për efikasitet energjetik apo efikasitet të resurseve të ndara nga IPF me mbështetjen e BERZH - Energji e kursyer (GJ/në vit)
Infrastrukturë e përmirësuar ekologjike (ujë, mbeturina, ujëra të zeza) në nivel lokal dhe komunal	- Mbështetja e efikasitetit të rritur dhe qëndrueshmërisë në sektorin për ujëra, duke e përfshirë distribuimin, trajtimin, pastrimin e ujërave si dhe kanalizimin dhe ujitjen . - Mbështetja e rezistencës ndaj ndryshimeve klimaterike të infrastrukturës dhe shërbimeve komunale dhe rajonale, duke e përfshirë edhe kontrollin e vërshimeve. - Promovimi i investimeve të qëndrueshme në nivel komunal me fokus të fuqishëm në ndërtimin e kapaciteteve dhe efikasitetit fiskal, si dhe ndihmesën e qyteteve gjatë ballafaqimit me sfidat ekologjike (për shembull, kornizë e “Qyteteve të gjelbra”, ngrohje në nivel të komunave menaxhimi me mbeturina të ngurta), duke i përfshirë edhe objektet me efikasitet energjetik dhe ndriçim rrugor. - Mbështetja e mobilitetit komunal me fokus në sistemet për transport urban dhe kontroll në komunikacion.	Totali i ujit të kursyer (m3/në vit)

6. Hartimi i komplementaritetit të partnerëve ndërkombëtarë në sferat e punës së BERZH



European Bank
for Reconstruction and Development

SFERAT E PUNËS SË BERZH

		Sektorë														Tjetër						
		Korporativ				Energji etik		Infrastrukturor				Financiar				Tranzicioni i gjelbër			Inkluzioni			
Investime vjetore indikative mesatare për periudhën (2015-2017), përveç nëse nuk është theksuar më ndryshe me përjashtim të mbështetjes buxhetore)		Agrobiznes	Industri e përgjithshme индустрија	Patundshmëri	TIK	Resurse natyrore	Energji elektrike	Ujë dhe ujëra të zeza	Transporti publik	Rrugë	Hekurudha	Banka	Sigurim	Financa NMVM	Kapital privat	Tregje të kapitalit	Efikasitet i ujit	Efikasitet i materialeve	Energji e qëndrueshme	Gjinia	Të rinj	Rajoni
BE*	EUR 99m																					
Banka Botërore	EUR 65m																					
BEI	EUR 36m																					
KfW	EUR 28m																					
USAID	EUR 5m																					
IFC	EUR 3m																					
BERZH	EUR 97m																					

€

Sferë e investimit të konsiderueshëm



Fokusi kryesor ndaj sektorit privat

P

Sferë e angazhimit të konsiderueshëm të politikave



Fokusi kryesor ndaj sektorit publik

Sferat potenciale për ashkëpunim



Ekologji:

Bashkëpunimi me KfW për efikasitetin e energjisë dhe të resurseve të komunave; lidhja e punës së USAID-it për kornizën ligjore për energjetikë;



Konkurrenca:

Mbështetje e angazhimeve të BE-së dhe USAID-it në përmirësimin e menaxhimit dhe klimës së biznesit dhe pjesëmarrjen në takimet koordinuese të KNF dhe të donatorëve të udhëhequr nga Qeveria dhe grupet e punës sektoriale të organizuara nga BE-ja.



Integrimi:

Bashkëpunim me BEI dhe Bankën Botërore për projekte të mëdha të infrastrukturës për lidhje në sferën e transportit, energjisë dhe gazit; mbështetje dhe kontribut drejt agjendës për lidhje të BE-së në bashkëpunim dhe koordinim me KNF të tjera përmes KIBP



Rezistenca:

Lidhja e punës së USAID-it për politikën në sferën e sektorit për faktoring dhe faktoring financiar dhe kompanive lizing

Shënim: Hartimi i aktiviteteve të INF bazohet në informacionet me qasje publike.

Investim i konsiderueshëm i INF definuar si projekte që i tejkalojnë 5% të investimeve vjetore që janë nënshkruar nga viti 2015 . Është përdorur bursa prej 8 qershorit 2018 .

* BE dhe BEI në mënyrë të konsiderueshme do ta rrisin mbështetjen e tyre financiare përmes programit IPA III dhe Nismës për rezistencë ekonomike me investime qëllimore prej 1 miliardë euro për 5 vitet e ardhshme

7. Rreziqe për implementimin, implikime ekologjike dhe sociale

Rreziqe për implementimin e strategjisë	Mundësia	Efekti	Implikime ekologjike dhe sociale
Kapaciteti i dobët administrativ mund ta anulojë zbatimin e reformave si edhe projektet e mëdha kritike të realizuara me garanci shtetërore			Vlerësimi dhe menaxhimi me ndikimet ekologjike dhe sociale, angazhimi i palëve të involvuara: Sigurimi se ndikimet ekologjike dhe sociale të drejtpërdrejta, të tërthorta, kumulative dhe ndërkufitare të projekteve janë vlerësuar në mënyrë përkatëse dhe se bëhet angazhimi përkatës i palëve të involvuara. Shqyrtimi i ndërtimit të kapaciteteve ekologjike dhe sociale me qëllim që të sigurohet miratimi i praktikave të mira ndërkombëtare.
Jostabiliteti politik dhe progresi i pamjaftueshëm i reformave mund ta zvogëlojnë besimin e investitorëve.			Fuqia punëtore dhe kushtet e punës: Sigurimi se politikat e ÇR dhe praktikave të punës së klientëve janë në pajtim me kërkesat e BERZH, veçanërisht në lidhje me plotësimin e kërkesave lidhur me kushtet për punë; menaxhimin me zbatuesit, diskriminimin potencial të vendit të punës dhe promovimin e mundësive të barabarta.
Bashkëfinancim i pamjaftueshëm i donatorëve dhe nivelet e granteve mund ta zvogëlojnë konkurrencën e produkteve kyçe të BERZH-it.			Efikasiteti i resurseve dhe parandalimi dhe kontrolli i ndotjes: Zhvillimi i nismave për ndërtimin e kapaciteteve në sektorin e infrastrukturës; identifikimi dhe zhvillimi i projekteve për përdorimin efikas të resurseve të ujit dhe nisma për ndihmë teknike si pjesë e tranzicionit drejt ekonomisë së gjelbër (TEGJ). Studimi i nismave potenciale për ndërtimin e kapaciteteve dhe dialogut politik për shkak të njoftimit të Teknikave më të mira qasëse për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes industriale në pajtim me Direktivat e BE-së për emetimet industriale.
Ndjeshmëria ndaj ndryshimeve klimaterike mund t'i anulojë projektet infrastrukturore kyçe.			Shëndet dhe siguri: Përmirësimi i shëndetit dhe sigurisë gjatë punës dhe në bashkësi, me theks të veçantë në aktivitete të cilat vlerësohen për fatkeqësi të shpeshta të paraqitura gjatë projekteve të Bankës. Theks i veçantë do t'i vihet sigurisë në rrugë përmes kërkesës për revizione të sigurisë në rrugë, ndërtimin e kapaciteteve dhe ngritjen e vetëdijes në kuadër të bashkësive të cilat i janë ekspozuar rrezikut.
Zvogëlimi i hapësirës fiskale e rrit rrezikun prej mosplotësimit të obligimeve dhe problemet me pagesën e borxheve të ndërmarrjeve publike.			Blerja e tokës, zhvendosja e detyrueshme dhe zhvendosja ekonomike: Sigurimi se të gjitha projektet të cilat kërkojnë blerjen e tokës janë në pajtim me kërkesat e Bankës për kompensim dhe kthimin e kushteve për jetë, me theks të veçantë tek abonuesit joformal të tokës dhe grupet e ndjeshme.
			Ruajtja e diversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve të gjalla natyrore: Zhvillimi i nismave për ndërtimin e kapaciteteve për vlerësime themelore të biodiversitetit, të cilat do të sigurojnë se të gjitha llojet e rëndësishme dhe vendbanimet janë mbrojtur aty ku janë projektet të cilat mund të rrezikojnë zona të mbrojtura natyrore, Emerald lokacione të propozuara dhe/apo zona kyçe për biodiversitet.
			Trashëgimia kulturore: Punë me klientët për qëllim të identifikimit dhe konsultimit me palët e interesuara kyçe lidhur me projektet në zonat me rëndësi kulturore dhe mbrojtjen e trashëgimisë së ndjeshme kulturore.
			Ndërmjetës financiarë: Sigurimi se partnerët-ndërmjetësit financiarë kanë përcaktuar kapacitete përkatëse ekologjike dhe sociale dhe procedura për menaxhim me rreziqet.
			Monitorimi dhe mbikëqyrja: Punë me klientët për qëllime të monitorimit të rezultateve ekologjike dhe sociale dhe zgjidhjen e çështjeve të hapura lidhur me portfolion e Bankës.

8. Vlerësimi i bashkëfinancimit prej donatorëve

8.1. Vlerësimi i nevojave prej granteve

Mjete plotësuese donatore do të jenë të nevojshme që të realizohen qëllimet strategjike për vitin 2023, duke e përfshirë edhe mbështetjen për:

- Zhvillimi infrastrukturor në pajtim me agjendën për lidhjen e Ballkanit Perëndimor, si në sektorin e transportit, ashtu edhe sektorin e energjetikës (përfshirë edhe gazin);
- Zhvillimi infrastrukturor në kuadër të Qyteteve të Gjelbra (duke e i përfshirë edhe transportin e qytetit dhe kapacitetet për trajtimin dhe pastrimin e ujit/ujërave të zeza)
- Zhvillimi i NVM dhe qasja në financa;
- Ndhimë teknike për sektorin digjital për shkak të përmirësimit të lidhjes TIK;
- Instrumente për ndarjen e rrezikut për zgjerimin e punës së BERZH drejt PFI me qëllim që të arrihet ndikim i madh tranzicioni. Në pika të përgjithshme, do të nevojitet financim prej granteve të dedikuara për rritjen inkluzive duke e përfshirë edhe përmes nismave të reja për punësimin e të rinjve dhe ndërmarrjeve sociale;
- Ndhimë teknike për reforma ligdhënëse në sfera si koncesione dhe partneritete publiko-private, decentralizimin e sektorit komunal, konkurrencë të rritur në tregun e energjisë elektrike, harmonizimin e furnizimeve publike me legjislaturën e BE-së dhe OBT.

8.2. Burime potenciale të mjeteve për grante

Korniza investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF – nismë e përbashkët e qeverive shfrytëzuese, BE, donatorëve bilateral dhe institucioneve financiare): grante për investime infrastrukturore prioritare në sektorin e transportit, atë energjetik, digjital, ekologjik dhe social. Deri në këtë moment, Këshilli drejtues i WBIF ka miratuar grante prej 93 milionë euro për Fondin e përbashkët evropian për Ballkanin Perëndimor për projekte të BERZH në Maqedoninë e Veriut. Strategjia kombëtare e sektorit dhe prioritetet rajonale janë parakusht për kualifikimin e pjesëmarrjes.

BE: sfera prioritare në kuadër të Instrumentit për ndihmë parainkuadruese përfshijnë zhvillimin e sektorit privat, efikasitet energjetik dhe infrastrukturës. Platforma EDIF do të shfrytëzohet për financimin e NVM dhe ndërtimin e kapaciteteve. Priten kontribute plotësuese për hua për financimin e efikasitetit energjetik për popullatën dhe shërbime këshillëdhënëse për biznese të vogla.

Financimi mund të fitohet prej Fondit të Gjelbër klimaterik dhe Fondit global ekologjik me qëllim që të mbështetjen projektet në kuadër të nismave të BERZH për tranzicion drejt ekonomisë të gjelbër.

Donatorë bilateral: mbështetje përmes programeve bilaterale të BERZH dhe fondeve speciale me më shumë donatorë (për garanci prej Programit për lehtësimin e tregtisë (PLT))

Fondi special i aksionarëve të BERZH: fond plotësues drejt resurseve donatore, ku zhvillimi tranzicionit edhe më tej është sferë prioritare.


Tregues të zgjedhur për qasje

BERZH rangim rajonal përqindësh ¹


BPV për kokë banori (PFB, dollarë amerikanë) ²	14,914	42 ^{ti}
Vend NZZH	Po	Nuk ka
NZZH si pjesëmarrje në të ardhurat bruto kombëtare (%) ³	1.38%	36 ^{ti}
Distribuími i NZZH për kokë banori (USD – çmime vijuese) ³	71.98	52 ^{ti}

Burime: ² FMN (2017), ³ OECF (2017)

Financimi prej donatorëve gjatë strategjisë së fundit (mil. euro) ⁴



Nevoja të projektuara jofinanciare prej granteve (mil. euro)*



1. Rangim i thjeshtë përqindësh i regjistruar si pjesëmarrje e vendeve të BERZH (NZZH për vendet e punës për tregues për NZZH) të cilët janë ranguar nën Maqedoninë e Veriut

4. Të dhëna për BT për 2013-2016 bazohen në të dhënat prej fundit të marsit, 2016 (data e fundit qasëse para migrimit të të dhënave në Sistemin e ri për fonde donatore. Të dhënat për 2016-2018 bazohen në alokime në nivel të projektit. Shumat e granteve bashkëinvestuese dhe huatë koncesionare bazohen në nënshkrimet e klientëve.

5. Nevojat e vlerësuara për financim përmes granteve bazohen në nevojat operative të cilat i kanë paraqitur ekipet bankare për projekte të cilat do të fillojnë në vitin 2019. Nevojat e vlerësuara për financim në përgjithësi e tejkalojnë përdorimin vijues të granteve, pasi disa nevoja mund të materializohen, mund të anulohen ose mund të ndahen në disa vite për grumbullimin e mjeteve financiare për shkak të nevojave operative dhe gjendjeve vijuese.



ANEKS

Përkushtimi i Maqedonisë së Veriut drejt zbatimit të parimeve politike të theksuara në Nenin 1 të Marrëveshjes për formimin e Bankës janë rrezikuar në mënyrë serioze në pjesën më të madhe të periudhës së miratimit të Strategjisë paraprake të vendit, pasi vendi u ballafaqua me përqendrim dramatik të gjendjes së demokracisë dhe për këtë në raportet relevante të BE-së u cilësua si “shtet i robëruar”, nga udhëheqësia e partisë politike së atëherëshme në pushtet. Qeveria e re e koalicionit me orientim reformues, e cila u formua në vitin 2017 pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare bëri hapa kyç për kthimin e kontrollit dhe baraspeshës në sistemin politik, e përforcoi demokracinë përmes dialogut politik më gjithëpërfshirëse dhe e ktheu pavarësinë e gjykatave.

„Mbetet korniza e përcaktuar ligjdhënëse për demokracinë parlamentare pluraliste, duke i përfshirë dispozitat kushtetuese për ndarjen e pushtetit, të drejtat kryesore dhe mbrojtjen e pakicave, si edhe për zgjedhje të lira. Megjithatë, derisa korniza juridike mbeti në pajtim me standardet evropiane dhe ndërkombëtare siç u vlerësua nga Këshilli i Evropës dhe OSBE-së, ekzistoi hendeq i konsiderueshëm midis legjislaturës dhe praktikës. Periudha pas miratimit të Strategjisë paraprake u shënua me krizën politike më serioze pas konfliktit të armatosur nga viti 2001. “Skandali me përgjimet” (publikimi, në intervale të rregullta nga shkurti 2015, i një numri të madh të komunikimeve të ndjekura midis funksionarëve të lartë) janë zbardhur keqpërdorime të shumta nga regjimi i cili atëherë ishte në pushtet, në një numër të madh sferash. Në konstatimet e Këshillit të Bashkimit Evropian në qershor të viti 2015 u theksua për “shkeljen e të drejtave fundamentale, lirinë e gjyqësisë, lirinë e mediave, zgjedhje, korrupsion, politizimin e institucioneve shtetërore dhe mjegullimin e lidhjes së ndarjes midis shtetit dhe partisë...”¹

Analiza e situatës nga Grupi special i ekspertëve të lartë të angazhuar nga Komisioni Evropian, me të cilin kryesoi Drejtori i pensionuar, Rajnhard Pribe (“Raporti i Pribesë”), çoi drejt disa rekomandimeve lidhur me ndryshimet në legjislaturë. Shumica prej tyre, nga ana tjetër, ka të bëjë me aktivitete të cilat janë pjesë e kornizës ligjore ekzistuese. Në vijim janë hetime penale të inicuar prej punës së Prokurorit Special i emëruar me qëllim që në mënyrë konkrete të përqendrohet në keqpërdorimet e zbardhura në skandalin e lartpërmendur me përgjimin dhe të përcaktohet përgjegjësia juridike. Por, rrënja e problemit qëndron në atë që një dokument tjetër i BE-së e cilësoi si “shtet i robëruar” nga udhëheqësia e partisë politike në pushtet.² Bëhet fjalë për korrupsion gradual të regjimit i cili ishte në pushtet prej vitit 2006 deri në vitin 2017, i cili u rrit në mënyrë të konsiderueshme nga fundi i kësaj periudhe, e përqendruar prej disa karakteristikave të përbashkëta për një numër të madh të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe institucione relativisht të dobëta dhe dobësi të përgjithshme të qeverisjes së drejtës, kulturë të pabarabartë të dialogut politik dhe mungesës së një administrate stabile, profesionale dhe të depolitizuar.

Qeveria e re e koalicionit me orientim reformues, e cila u formua në vitin 2017 pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të cilat u mbajtën në dhjetor të vitit 2016, e kryesuar nga ish-partia politike kryesore në opozitë, LSDM-ja qendrore-majtiste, i përcaktoi përmirësimet në sferën e qeverisjes së të drejtës dhe agjendës reformuese gjithëpërfshirëse si komponentë kryesorë të programit të saj. Autoritetet e reja ndërmorën hapa të parë të rëndësishëm për ballafaqim me atë që u përmend më parë “robërim i shtetit” përmes kthimit gradual të kontrolleve dhe baraspeshës dhe përforcimit të demokracisë me dialog politik më gjithëpërfshirës dhe kthimin e pavarësisë në gjyqësi.

Angazhimet për kthimin e funksionimit të demokracisë në Maqedoninë e Veriut dhe në zhvillimin e agjendës reformuese si dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në vend dhe marrëdhëniet me fqinjët rajonal, përfshirë edhe zgjidhjen e çështjes së emrit me Greqinë,, u reflektua në vlerësimet e BE-së. Strategjia e re për Ballkanin Perëndimor e publikuar në shkurt të vitit 2018, Raporti i KE-së për Maqedoninë e Veriut nga prilli i vitit 2018 dhe Konstatimet e Këshillit të BE-së nga 26 qershori 2018 e cilësuan progresin e arritur në sferat e lartshënuara si “të rëndësishëm”. Në bazë të kësaj më 17 prill 2018, KE i publikoi rekomandimet për fillimin e negociatave Maqedoninë e Veriut për hyrje në BE. Këshilli i BE-së në takimin e tij të mbajtur më 26 qershor 2018, u pajtua që në mënyrë pozitive t’i përgjigjet progresit të lartpërmendur, përmes përgatitjes së rrugës drejt fillimit të negociatave për hyrje në qershor të vitit 2019, duke pritur miratimin e Këshillit të Evropës.³

1. Këshilli i Bashkimit Evropian, rekomandime të Këshillit të Maqedonisë së Veriut, Kumtesë për media, 23 qershor 2015

2. Komisioni Evropian, Raport nga viti 2016 për Maqedoninë e Veriut, Kumtesë prej Komisionit të Parlamentit Evropian, Këshilli, Komitetit evropian ekonomik dhe social dhe Komitetit të rajoneve, 2016 Kumtesë për politikën e zgjerimit të BE-së, 9.11.2016.

3. Komisioni Evropian, 2018 Kumtesë për politikën e zgjerimit të BE-së , 17.04.2018; Këshilli për çështje të përgjithshme, Zgjerimi dhe Procesi i stabilizimit dhe asociimit, Konstatime të Këshillit, 26.06.2018

Qeveri reprezentative dhe përgjegjëse

Zgjedhje të lira, korrekte dhe konkurrenente

Midis 120 dhe 123 deputetë janë zgjedhur për mandat katërvjeçar përmes sistemit të përfaqësimit proporcional. Në secilën prej gjashtë njësive zgjedhore në vend zgjidhen nga 20 deputetë. Si rezultat i ndryshimeve të vitit 2015, më së shumti tre deputetë plotësues zgjidhen në njërën njësi zgjedhore jashtë vendit. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është trupi më i lartë i pavarur, i emëruar nga kuvendi me mandat katërvjeçar. Kodi zgjedhor parasheh vëzhgim vendor dhe ndërkombëtar të zgjedhjeve në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore.

Korniza ligjore ekzistuese mundëson bazë të fuqishme për zgjedhje demokratike, me kusht autoritetet dhe partitë politike të tregojnë gatishmëri të mjaftueshme për zbatimin e saj. Një sërë reformash të zbatuara gjatë viteve sollën përfitime pozitive për kornizën ligjore. Herën e fundit, ajo u rishikua në vitin 2015 dhe 2016, si pjesë e marrëveshjes midis qeverisë dhe opozitës të arritur me ndërmjetësimin e BE-së për qëllime të tejkalimit të krizës politike serioze. Me këto ndryshime u përfshinë rekomandime të shumta paraprake të Zyrës së OSBE-së për të drejta të njeriut dhe institucione demokratike (ODIHR) dhe nga Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venecias), duke përfshirë edhe masa kyçe për ndarjen e partisë prej shtetit, përbërjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) dhe mbulimin medial. Njëherësh, krahas përmirësimeve të Kodit Zgjedhor disa probleme të caktuara shumëvjeçare mbetën të pazgjidhura duke e përfshirë edhe karakterin me dy kuptime të disa dispozitave të caktuara dhe përplasjen e tyre me ligje dhe rregulla të tjera. Përveç rekomandimeve të tjera, propozimi më i ri i OSBE-së përfshin pasqyrë gjithëpërfshirëse të Kodit Zgjedhor për qëllime të harmonizimit.⁴

Megjithatë, si edhe në shumë sfera të tjera, problemi kyç qëndron në hendekun midis legjislaturës dhe praktikës. Derisa parë historikisht, OSBE kryesisht i vlerësoi zgjedhjet si konkurrenente dhe se kandidatët mundën lirshëm të zbatojnë fushatë në disa zgjedhje gjatë dekadës së fundit u nënvizua “mjegullimi i linjës së përkufizimit midis aktiviteteve të partisë dhe shtetit”. Gjatë kësaj periudhe, vazhdimisht kishte deklarata lidhur me presione dhe frikësime. Gjithashtu ekziston edhe historia e dhunës zgjedhore. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat u mbajtën në vitin 2004 shkaktuan brengosje lidhur me parregullsitë e shumta në të cilat u përfshinë autoritete, të cilat më pas u konfirmuan me zbulime në kuadër të skandalit me përgjimin në vitin 2015. Hetimi është në vijim.

E kaluara e tillë problematike çoi në uljen e besimit të opinionit në institucionet shtetërore dhe kredibilitetin e procesit zgjedhor. Duke e pasur parasysh atë, zgjedhjet e fundit parlamentare të cilat u mbajtën në dhjetor të vitit 2016 dhe zgjedhjet e fundit lokale, të cilat u mbajtën në tetor të vitit 2017, ishin hapa të rëndësishëm në drejtim të vërtetë. Edhe krahas pohimeve të vazhdueshme kredibile për blerje votash, frikësimin e votuesve dhe presionin ndaj nëpunësve shtetërorë, zgjedhjet në vitin 2016, të cilat ishin me rëndësi esenciale për zgjidhjen e krizës së thellë politike, kaluan pa incidente të mëdha. OSBE nënvizoi se “kandidatët mundeshin lirshëm t’i udhëheqin fushatat e tyre” dhe se “në përgjithësi janë respektuar liritë themelore”⁵. Zgjedhjet lokale, të cilat u mbajtën në tetor, 2017, kontribuan për përforcimin e besimit të opinionit në procesin demokratik. Misioni vëzhgues për zgjedhje i OSBE-së e theksuan “mjedisin konkurrues”, “mbulimin e paanshëm medial” dhe “sjelljen shembullore”.⁶

4. OSBE/ODIHR, Maqedonia e Veriut, Zgjedhje të parakohshme parlamentare, 11 dhjetor, 2016, OSBE/ODIHR, Misioni ndërkombëtar vëzhgues i zgjedhjeve, 28 shkurt 2017
5. OSBE/ODIHR, Maqedonia e Veriut, Zgjedhje të parakohshme parlamentare, 11 dhjetor, 2016, OSBE/ODIHR, Misioni ndërkombëtar vëzhgues i zgjedhjeve, 28 shkurt 2017
6. OSBE/ODIHR, Misioni ndërkombëtar vëzhgues i zgjedhjeve, Maqedonia e Veriut, Zgjedhje lokale, Deklaratë për konstatimet dhe rezultatet preliminare, 15 tetor 2017.

Ndarja e pushtetit dhe kontrolli efektiv dhe baraspesha

Korniza kushtetuese dhe ligjore për demokraci parlamentare – e mbështetur me ndarjen e pushtetit dhe kontrollet dhe baraspeshën në sistemin politik, legjislativën e pavarur dhe procedurat për mbikëqyrje ligjdhënëse në domenet e rregulluara të vendimmarrjes – është garantuar në Kushtetutën dhe ligjet e Maqedonisë së Veriut, të cilat në masë të madhe janë harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, siç vlerësoan Këshilli i Evropës dhe BE. Fushëveprimi i autorizimeve të pushtetit ligjdhënës të sigurojë përgjegjësi të qeverisë dhe të bëjë mbikëqyrje parlamentare në masë të madhe është harmonizuar me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, në dekadën e fundit ekzistonte hendek i rëndësishëm midis legjislativës dhe praktikës. Mangësitë dolën në pah gjatë skandalit me përgjimet në vitin 2015. Në Rezolutën e vet prej marsit 2017 Parlamenti Evropian nënvizoi se “kriza politike e para ca kohësh e tregoi mungesën e sistemit efektiv të kontrolleve dhe baraspeshës në institucionet e Maqedonisë”.⁷ Midis rasteve më shqetësuese të zbardhura me skandalin e përgjimeve ishte përzierja e vazhdueshme politike në punën e gjyqësisë. Kriza politike i theksoi dobësitë e kuvendit dhe trupave të pavarur rregullator dhe mbikëqyrës në pjesën e zbatimit të funksioneve të tyre mbikëqyrëse. Nga vera e vitit 2017, qeveria e re me orientim reformues ndërmoi hapa për kthimin gradual të kontrolleve dhe baraspeshës, përf forcimin e demokracisë dhe qeverisjen e së drejtës.

Fuqia efektive për qeverisjen e funksionarëve të përzgjedhur

Maqedonia e Veriut ka vendosur aranzhime institucionale, juridike dhe financiare me qëllim që funksionarët e përzgjedhur të kenë fuqi efektive për qeverisje dhe të mos jenë të kufizuar prej të drejtës jodemokratike të vetos apo ndikimeve të tjera jopërkatese. Si edhe te shumë vende të tjera në tranzicion, ekziston marrëdhënie e afërt shumëvjeçare midis biznesit dhe elitave politike.

Shoqëria civile, mediat dhe pjesëmarrja

Vëllimi dhe pavarësia e shoqërisë civile

Ekziston kornizë ligjore e kënaqshme për organizatat e shoqërisë civile (OSHC). Për momentin në Regjistrin qendror të Maqedonisë janë regjistruar mbi 14.000 OSHC, në bazë të procedurës së thjeshtë dhe transparente të regjistrimit. Në maj të vitit 2016, u soll vendimi për formimin e Këshillit për bashkëpunim midis Qeverisë dhe shoqërisë civile, vetëm dy ditë pas prezentimit të tij fillestar tek organizatat civile dhe pa mundësimin e konsultimeve plotësuese. Që atëherë Zyra për bashkëpunim me organizata joqeveritare në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë mbajti konsultime me organizatat e shoqërisë civile me qëllim të rishikimit të vendimit, me qëllim që të krijohet Këshill funksional dhe i pranuar gjerë për bashkëpunim. Si në gjithë Ballkanin Perëndimor, OSHC akoma në masë të madhe varen prej financimeve të huaja, OSHC nuk fitojnë benefite të veçanta si subjekte jofitimprurëse, por mund të kyçen në aktivitete komerciale, derisa të ardhurat e tyre janë në pajtim me qëllimet e tyre ligjore. Nga viti 2015, OSHC duhet të paguajnë tatim të fitimit për të ardhura prej aktiviteteve komerciale.

Disa OSHC janë me profesionalizëm të lartë në sferat e tyre të ekspertizës, veçanërisht ato të cilat janë specializuara për çështjet lidhur me integrimin në BE, mjedisin jetësor, mediat dhe çështjet gjinore. OSHC janë aktive në sferën sociale, duke e përfshirë mbrojtjen e grupeve të ndjeshme dhe të marginalizuara dhe në vëzhgimin e zgjedhjeve. Një prej dobësive të theksuara është zhvillimi i shoqërisë civile në nivel lokal, veçanërisht në mjediset rurale.

7. Parlamenti Evropian, Raport për Raportin e Komisionit për Maqedoninë e Veriut, Komiteti për punë të jashtme, 6 mars 2017.

Edhe pse OSHC u goditën nga regresi në standardet demokratike gjatë qeverisjes së regjimit paraprak, ndërsa mjedisi në të cilin punojnë u përkeqësua në mënyrë të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe, shumë prej tyre e ruajtën angazhimin për promovimin e demokracisë. Shoqëria civile luajti rol të rëndësishëm në krijimin e ndryshimeve të cilat kulmuan në uljen e regjimit diskreditues në vitin 2017. Që atëherë, OSHC vazhduan t'i mbështesin proceset demokratike. Nga vera e vitit 2017, klima në të cilën punojnë u përmirësua në mënyrë të konsiderueshme, ndërsa qeveria tregon angazhim për dialog dhe inkluzion.

Të drejtat për formimin e sindikatave janë garantuar me ligj dhe respektohen në praktikë. Megjithatë, sindikatave kryesisht u mungojnë financa stabile. Këshilli ekonomiko-social luan rol gjithnjë e më aktiv në dialogun social.

Pavarësi dhe pluralizëm në mediat të cilat punojnë pa censurë

Ekzistojnë mbi 130 kanale televizive dhe radio të cilat punojnë në një treg relativisht më të vogël në të cilin dominojnë mediat elektronike. Medie kryesore është servisi publik radiodifuziv, Radio Televizioni i Maqedonisë (RTVM), me tre kanalet e veta kombëtare, një kanal satelitor dhe tre radio stacione kombëtare. Mediat, i përfshijnë edhe mediat e shtypit, tirazhi i së cilave është relativisht i ulët janë të ndara në bazë politike dhe etnike që e reflektojnë polarizimin e përgjithshëm në shoqëri.

Shkalla e penetrimit të internetit është në rritje të vazhdueshme, kështu që 69% e qytetarëve kishin qasje në internet në vitin 2016, në krahasim me 29% në vitin 2006.⁸ Mediat sociale luajnë rol gjithnjë e më të rëndësishëm, me ç'rast në vitin 2016 kishte rreth një milion përdorues në Fejsbuk.⁹ Edhe pse korniza ligjore në masë të madhe është përcaktuar dhe është në pajtim me standardet ndërkombëtare, në të kaluarën, arsytet për brengosje në mënyrë tradicionale ka të bëjë me vetëcensurën dhe mungesën e pavarësisë redaktuese për shkak të interesave politike dhe të biznesit. Kjo e fundit mori dimension të ri në kuadër të skandalit me përgjimin në vitin 2015, i cili zbuloi shembuj shokues të involvimit politik në media.

Me marrëveshjen prej vitit 2015 për tejkalimin e krizës politike u arrit me ndërmjetësimin e BE-së u parashikuan masa të shumta në sferën e reformave në media. Nga vera e vitit 2017 zbatohen konsultime të gjera midis palëve të involvuara për ndryshime në sferën e mediave. Me qeverinë e re me orientim reformues, klima për lirinë e mediave në mënyrë të konsiderueshme u përmirësua me debat më të hapur politik. Reklamimi qeveritar përfundoi dhe presioni ndaj gazetarëve u zvogëlua.

Më shumë kanale për pjesëmarrje qytetare dhe politike

Ekzistojnë më shumë kanale për pjesëmarrje qytetare dhe politike edhe pse në të kaluarën ato u minuan seriozisht nga ajo që KE e cilësonte si “shtet të robëruar” nga udhëheqësia e partrisë në pushtet. Ekzistojnë disa rregulla të caktuara dhe procedura lidhur me konsultimet publike por ato jo gjithmonë zbatohen. Për shembull, sistemi zhvillimor për regjistrin elektronik të të gjitha projekt-ligjeve të sapopërgatitura, i cili është paraparë me rregullat, nuk ka përdorim të gjerë në praktikë. Edhe pse komisionet parlamentare kërkojnë prej OSHC ta ndajnë ekspertizën e tyre, kjo zakonisht bëhet në bazë ad-hok. Autoritetet e reja ndërmorën hapa të konsiderueshëm që të prekin deri tek palët e involvuara dhe ta kthejnë inkluzionin dhe transparencën në procesin demokritik.

8. Internet Live Stats: <http://www.internetlivestats.com/internet-users/macedonia/>

9. Internet World Stats: <http://www.internetworldstats.com/europa2.htm>

Liria e formimit të partive politike dhe ekzistimi i opozitës së organizuar

Në zgjedhjet e fundit parlamentare në Maqedoninë e Veriut morën pjesë gjashtë parti politike dhe pesë koalicionë. Liria e formimit të partive politike është e garantuar me Kushtetutën dhe zbatohet në praktikë, që është e dukshme nga ekzistimi i opozitës së konsiderueshme e cila mund të zbatojë lirshëm fushata dhe t'i kundërshtojë nismat qeveritare. Partia politike kryesore opozitare për momentin i ka mbi 40% të vendeve në kuvendin kombëtar, përfaqësuesit e saj kryesojnë me disa komisione kyçe dhe kanë shumicë në disa komuna.

Qeverisja e së drejtës dhe qasja në drejtësi

Qeverisja e së drejtës

Edhe krahas ekzistimit të dispozitave ligjore, regresi i përgjithshëm i standardeve demokratike gjatë qeverisjes së regjimit paraparak, i cili manifestohej me rritjen e kufirit midis shtetit dhe partisë në pushte, në mënyrë negative ndikoi në parimin e qeverisjes të së drejtës. Autoritetet e reja filluan ta anulojnë regresin, veçanërisht përmes kthimit të pavarësisë në gjyqësi. Një prej sferave kyçe në “Prioritetet reformuese urgjente” të miratuara nga qeveria e re është sigurimi i autonomisë së trupave të pavarur rregullator, mbikëqyrës dhe kontrollues.

Pavarësia e gjyqësisë

Pavarësia e gjyqësisë është garantuar me kushtetutën dhe vendi ka përmbledhje gjithëpërfshirëse të rregullave të cilat nëse respektohen, duhet të sigurojnë standard të lartë të gjyqësisë dhe pavarësisë së tij të plotë. Megjithatë, zbardhja në kuadër të skandalit me përgjimet tregoi se ekziston hendek midis kornizës ligjore dhe praktikës, duke përfshirë këtu edhe dëshmi të marra përmes ndjekjes së komunikimeve, për involvimin politik në nominimin dhe emërimin e gjykatësve. Raporti i KE për Maqedoninë e Veriut nga viti 2016 nënvizoi se “nuk ka progres në sigurimin e pavarësisë funksionale në sistemin gjyqësor” edhe krahas marrëveshjes së arritur midis qeverisë dhe opozitës me ndërmjetësimin e BE-së.¹⁰ Pas ndryshimit të regjimit në verën 2017, janë vërejtur ndryshime pozitive kundrejt regresit prej viteve të mëparshme. U arrit progres konkret në kthimin e pavarësisë në gjyqësi. Vendi miratoi strategji të re për reforma gjyqësore për vitet 2017-2022 dhe Plan veprues i cili do ta sigurojë bazën e reformave të mëtejme. Këshilli i BE-së në Konstatimet e veta të 26 qershorit 2018 i inkurajoi autoritetet të vazhdojnë me zbatimin e kësaj strategjie me qëllim që të sigurohen se gjyqësia mund të funksionojë e pavarur.¹¹

Qeveria dhe qytetarët janë të barabartë para ligjit

Edhe pse Maqedonia e Veriut ka përmbledhje gjithëpërfshirëse të rregullave të cilat, nëse respektohen duhet të sigurojnë zbatim konsekuent të këtij parimi, as ajo nuk mbeti imun në regresin gjatë regjimit paraparak. Skandali me përgjimin e zbardhi raste të shumta të keqpërdorimit të pushtetit dhe detyrës zyrtare, llogaridhënie të zvogëluar dhe mosrespektim të etikës profesionale. Nga vera e vitit 2017, autoritetet e reja filluan të punojnë në anulimin e regresit të tillë dhe treguan dëshirë të sinqertë për kthimin e demokracisë dhe qeverisjes të së drejtës. Në janar të vitit 2018 u formua Këshilli i ri këshilldhënës për etikë gjyqësore.

10. Komisioni Evropian, Raport për Maqedoninë e Veriut për vitin 2016, Kumtesë nga Komisioni në Parlamentin Evropian, Këshill, Komitetin evropian ekonomik dhe social dhe Komitetin e rajoneve. Kumtesë për politikën e Zgjerimit të BE-së, 9 nëntor 2016.

11. Këshilli për punë të përgjithshme(GAC), Zgjerimi dhe procesi i stabilizim asociimit (SAP), Konstatime të Këshillit, 26.06.2018

Politika efektive dhe institucione për parandalimin e korrupsionit

Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë sfera dhe situata i përkeqësua gjatë viteve të fundit prej regjimit paraprak. Skandali me përgjimet i zbardhi raste të shumta të korrupsionit duke e përfshirë edhe korrupsionin në nivel të lartë në të cilin janë përfshirë funksionarë të lartë qeveritarë dhe partiak. Indeksi më i ri (2018) për perceptimin e korrupsionit¹² i Transparensi Interneshënall e rangoi Maqedoninë e Veriut në pozitën e 93-të prej 176 vendeve, që paraqet ulje të konsiderueshme në krahasim me gjendjen që para disa vitesh, kur vendi ishte në pozitën e 66-të prej 168 vendeve por paraqet përmirësim në krahasim me vitin 2017.

Është përcaktuar kornizë ligjore dhe institucionale për luftë kundër korrupsionit. Sipas Grupit të shteteve kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës (GREKO), korniza ligjore i përfshin më shumë sfera të cilat shqyrtohen në raundin e katërt të vlerësimit të GREKO. Megjithatë, GREKO nënvizoi se edhe krahas kornizës së fuqishme ligjore, zbatimi efektiv dhe zbatimi i legjislaturës mbeten arsye për brengosje dhe duhet të zgjidhen si detyrë prioritare.¹³ Në raportin e fundit të vitit 2014, GREKO do t'i japë Maqedonisë së Veriut 19 rekomandime për parandalimin e korrupsionit lidhur me deputetë, gjykatës dhe prokurorë. Në raportin e vet të harmonizimit prej vitit 2016, GREKO konstaton se Maqedonia e Veriut në mënyrë të kënaqshme zbatoi apo në mënyrë të kënaqshme u ballafaqua vetëm me tre prej 19 rekomandimeve të përmbajtura në raportin e raundit të katërt të vlerësimit.¹⁴

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) mbetet institucioni kryesor përgjegjës për parandalimin e korrupsionit. Integriteti i saj u kompletua gjatë regjimit paraprak dhe do të duhen angazhime që ajo të bëhet me të vërtetë e pavarur prej partive politike. Prokuroria Publike Speciale e formuar në pajtim me marrëveshjen midis qeverisë dhe opozitës me ndërmjetësimin e BE-së në zenitin e krizës politike në vitin 2015, paraqet vegël të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit. Për momentin janë disa raste të korrupsionit të nivelit të lartë të cilët kanë hyrë në procedurë gjyqësore, ndërsa janë shqiptuar edhe më shumë aktgjykime të shkallës së parë.

Të drejta politike dhe qytetare

Liria e shprehjes, informacione, religjioni, vetëdija, lëvizja, bashkimi, grumbullimi dhe pronësia private

Maqedonia e Veriut është nënshkruese e të gjitha instrumenteve kryesore ndërkombëtare për të drejta të njeriut. Niveli i lartë i ratifikimit të konventave të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe instrumenteve rajonale për të drejta të njeriut paraqet arritje të konsiderueshme. Maqedonia e Veriut përcaktoi edhe kornizë institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e cila e përfshin edhe Avokatin e Popullit. Vlerësimi më i ri i rezultateve të Maqedonisë së Veriut në sferën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në kuadër të Raportit universal periodik të Kombeve të Bashkuara u aprovua në vitin 2014. Një pjesë e rekomandimeve kryesore ishin edhe ato që lidhen me pakicat (22% e rekomandimeve), të drejtat e fëmijëve (20%) dhe liria e mediave (14%). Maqedonia e Veriut pranoi 91% prej gjithsej 136 rekomandime të dhëna në kuadër të procesit të përgatitjes së raportit.¹⁵

12. Indeksi për perceptimin e korrupsionit të Transparensi Interneshënall, 2017.

13. GREKO, Raundi i katërt i vlerësimit, Raport për vlerësim, Maqedonia e Veriut Parandalimi i korrupsionit lidhur me deputetët, gjykatësit dhe prokurorët, i publikuar më 17 mars, 2014.

14. GREKO, Raundi i katërt i vlerësimit, Raport për harmonizim, Maqedonia e Veriut, Parandalimi i korrupsionit lidhur me deputetët, gjykatësit dhe prokurorët, i publikuar më 12 tetor, 2016.

15. Kombet e Bashkuara, Raport periodik universal (RPU), Maqedonia e Veriut dhe RPU info statistikë, në dispozicion në https://www.upr-info.org/database/statistics/index_sur.php?fk_sur=101&cycle=2

Kushtetuta dhe ligjet relevante e ndalojnë diskriminimin në bazë të gjinisë, racës, gjuhës, religjionit, origjinës kombëtare dhe sociale, statusit pronësor apo social. Kushtetua i garanton liritë themelore dhe të drejtat e njeriut të pranuar me të drejtën ndërkombëtare, derisa marrëveshje ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të krahasueshme për gjykatat vendore dhe ato mbizotërojnë mbi ligjet kombëtare. Që këtu liria e shprehjes, informimi, konfesionit dhe vetëdija, lëvizja, bashkimi, grumbullimi dhe pronësia private është tërësisht e garantuar. Kushtetuta, gjithashtu, kërkon prej shtetit ta mbështesë nismën private dhe përgjegjësinë lidhur me “qëllimet sociale” të caktuara, siç është siguri i kujdesit për personat me aftësi të kufizuara, për personat e moshuar dhe fëmijët pa prindër.

Derisa korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në masë të madhe është harmonizuar me standardet evropiane, skandali i përgjimit prej vitit 2015 zbardhi shkelje serioze të të drejtave themelore me çka u theksua hendeku midis legjislaturës dhe praktikës. Qeveria e re e formuar në qershor të vitit 2017, iu përkushtua anulimit të regresit në sferën e të drejtave themelore të krijuar gjatë viteve të kaluara.

Lidhur me të drejtat pronësore, është arritur progres në kthimin e pronës së marrë nën regjimin komunist. Prona e cila nuk mund të kthehej u kompensua në formë të obligacioneve.

Inkluzioni politik për gratë, pakicat etnike dhe të tjera

Korniza legjislativë për mbrojtjen e pakicave etnike në masë të madhe është vendosur. Vendi ka përbërje të përzier etnike. Sipas regjistrimit të vitit 2002, maqedonasit etnik janë 64,2%, shqiptarët etnik 25,2%, turqit etnik 3,9%, romët 2,7%, serbët etnik 1,8%, boshnjakët etnik 0,8% dhe vllahët 0,5%. Përpjekjet për t'u organizuar regjistrimi në vitin 2011 dështoi për shkak të mospajtimeve midis bashkësive etnike lidhur me metodologjinë.

Maqedonia e Veriut ka histori me tensionet etnike. Megjithatë, është arritur progres pas konfliktit të armatosur prej vitit 2001 lidhur me zgjidhjen e rrënjëve dhe efekteve të konfliktit. Angazhimet e tilla përfshijnë reformë legjislativë dhe masa praktike të dizajnuara që të sigurojnë përfaqësim të drejtë të bashkësive pakicë në administratën publike, integrimin e tyre në shoqëri dhe promovimin e pajtimit ndëretnik. Interesat e bashkësive pakicë janë mbrojtur në nivele të ndryshme, duke filluar prej garancive themelore kushtetuese (bashkësitë etnike janë të shënuara në Kushtetutë) e deri tek mekanizmat e veçanta të cilat sigurojnë mbrojtje të interesave të tyre në kuvend dhe masa për mbrojtjen e identitetit të tyre kulturor, gjuhësor dhe fetar. Rezultatet më të mëdha në këtë kontekst janë arritur në pjesën e mbrojtjes së interesave dhe sigurimit të përfaqësimit të drejtë të pakicës më të madhe etnike, shqiptare. Akoma duhet punuar me qëllim që të mbrohen pakicat më të vogla etnike, siç është bashkësia më e ndjeshme, rome.

Edhe krahas progresit të arritur, akoma ekzistojnë tensione ndëretnike dhe mungesë e besimit të ndërsjellë, veçanërisht në nivel lokal. Partitë politike në masë të madhe janë të ndara në bazë etnike. Implementimi i Marrëveshjes së Ohrit (MO), e cila në masë të madhe ka të bëjë me pajtimin ndëretnik edhe më tej mbetet me rëndësi esenciale për ruajtjen e stabilitetit të vendit. Ajo edhe më tej mbetet faktor për mbështetjen e stabilitetit politik që është e dukshme edhe prej funksionimit të papenguar relativ të koalicionit multietnik qeveritar aktual. Qeveria e re e formuar nga mesi i vitit 2017 ndërmori më shumë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të besimit më të madh midis bashkësive etnike. Në mesin e tyre është sjellja e ligjit të ri për përdorimin zyrtar të gjuhëve etnike në administratën publike.

Lidhur me romët, u ndërmorën më shumë masa, veçanërisht për zgjidhjen e çështjes së personave pa dokumente dhe integrimin e personave të zhvendosur përbrenda vendit dhe refugjatët romë të Kosovës. “Mediatori shëndetësor rom” filloi në 16 komuna. Vazhduan të zbatohen projekte arsimore gjë që çoi drejt rritjes së shkallës së regjistrimit të fëmijëve romë në institucionet arsimore (për momentin, 78% e fëmijëve romë të moshës shkollore regjistrohen në arsimin e obligueshëm). Megjithatë, zbatimi i strategjive ekzistuese, duke e përfshirë edhe strategjinë për inkluzionin e romëve për vitin 2014-2020, duhet të përfordhet. Akoma janë të pranishme shkallët e larta të papunësisë, ndërsa qasja në beneficinet për papunësi dhe shërbime shëndetësore mbetet problematike. Stereotipizimi ndaj romëve vazhdon, duke i përfshirë edhe mediat.

Maqedonia e Veriut i ka vendosur elementet ligdhënëse kryesore për barazi gjinore. Në dhjetor 2017 u ratifikua Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave (Konventa e Stambollit). Sipas standardeve rajonale (dhe më të gjera ndërkombëtare), gratë gjatë dekadës së kaluar patën përfaqësim impresiv në kuvendin kombëtar. Përfaqësimi i tyre arriti deri në 35% përbërjen kuvendore, ndërsa në kuvendin momental është 31,6%. Në pajtim me kuotën e rritur për pjesëmarrjen e grave është paraparë me Kodin zgjedhor (ritje prej 30 në 40%), 41% prej kandidatëve në zgjedhjet e fundit parlamentare ishin gra.

Megjithatë, në nivel lokal, situata është më ndryshe. Gratë kryetare komunash janë pak në numër. Gjatë zgjedhjeve të fundit lokale vetëm 6% e kandidatëve për kryetar komune ishin gra. Traditat diskriminuese dhe stereotipat, të cilat i shkelin të drejtat themelore të grave, akoma janë të pranishme në mjediset rurale.

Kryeministri i ri dhe anëtarët e qeverisë së tij dhanë mbështetje publike për të drejtat e personave LGBT dhe janë të përkushtuar të arrijnë progres në këtë sferë. Megjithatë, paragjykimet shoqërore vazhdojnë dhe gjuha e urrejtje kundër LGBT është e pranishme në media dhe në rrjete sociale.

Liri nga torturimi dhe frikësimi

Garancitë kushtetuese kundër torturimit dhe frikësimit janë përcaktuar de në masë të madhe respektohen në praktikë. Delegacioni i Komitetit Evropian të Këshillit të Evropës për parandalimin e torturës dhe veprimit jonjerëzor dhe nënçmuese apo dënimit (KST) për herë të fundit realizoi ad hok vizitë në Maqedoninë e Veriut në dhjetor, 2016. Qëllimi primar i vizitës ishte të shqyrtohen kushtet për mbylljen dhe trajtimin e të burgosurve në burgun e Idrizovës, në të cilin ndodhen më shumë se dy të tretat e të burgosurve në vend. Për shumë vjet KST e kritikonte situatën në këtë institucion, në të cilin ndodhen më shumë se dy e treta e të burgosurve në vend. Shumë vite me radhë KST e kritikonte situatën në këtë institucion, duke theksuar se kushtet në disa reparte mund të përshkruhen si jonjerëzore dhe me trajtim degradues. KST në raportin e fundit e ruan qëndrimin se problemet sistematike të cilat u identifikuan gjatë vizitave paraprake akoma nuk janë zgjidhur. Për këtë arsye, në konstatimin e raportit, Komiteti e cilësoi kualitetin e marrëdhënies së tij me Maqedoninë e Veriut “si shumë të pakënaqshme”.¹⁶ Qeveria e re e mori për sipër t’i marrë parasysh rekomandimet e KST dhe të arrijë progres në parandalimin e ngacmimit dhe torturës. U miratua edhe strategjia për zero tolerancë për torturat.

16 . Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për parandalimin e torturës dhe veprimit jonjerëzor dhe nënçmues apo dënimit (KST), Raport nga Qeveria e „Maqedonisë së Veriut“ për vizitën në Maqedoninë e Veriut“ nga KST prej 6 deri më 9 dhjetor, 2016 , të publikuar më 12 tetor, 2017 .